# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar**

**në "Stomatologji"**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**"Universiteti i Mjekësisë, Tiranë"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. PhD. Erlind Pepla

2. PhD. Nilena Eriksen


Mars/2020

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Përshkrim përmbledhës;**

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare, kanë kërkuar akreditimin e Programit të studimit Master i Shkencave në Stomatologji. Ky program është i ciklit të dytë të studimit dhe është hapur për herë të parë në vitin 1956. (licensimi). Universiteti i Mjekësisë ka një histori disa vjeçare si institucion më vete por ndërkohë ka një histroi të gjatë në ofrimin e programeve të mjekësisë nga Fakulteti i Mjekësisë, si pjesë e Universitetit të Tiranës.
Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit në vitin 2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike dhe e konsideruar si një nga vlerësimet më pozititive në univrsitetet publike.
Fakulteti i Mjekësisë Dentare është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë që formon specialistë të fushës së stomatologjisë në Republikën e Shqipërisë, ku cdo vit pranohen një numër i kufizuar studentësh. FMD aktualisht ofron programe në të tre ciklet e studimit, 1 program të ciklit të dytë, 2 programe të ciklit të parë, 1 program specializimi afatgjatë dhe 3 programe doktorature (Manuali i studentëve). MSc. Stomatologji është program i ntegruar me zgjatje 5 vite / 300 kredite dhe ofrohet në nivel njësie kryesore dhe përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është vetë fakulteti ndërsa njësitë bazë dhe strukturat e tjera japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit., (rregullore FMD).

Në këtë program janë të regjistruar dhe vazhdojnë studimet rreth 550 studentë dhe janë të angazhuar rreth 80 pedagogë me kohë të plotë e të pjesshme (statistika përmbledhëse)

Programi ka qënë objekt i vazhdueshëm ndryshimesh dhe përditësimesh në zbatim të VKM 41/2018 dhe kuadrit ligjor por sipas deklarimeve edhe për ta përshtatur programin më shumë me tregun e punës.

Grupi i jashtëm e vlerëson kontributin që ka dhënë ky program studimi në ngritjen dhe fuqizimin e edukimit në fushën e dentistrisë në vend. Sikundër është theksuar edhe në raport por edhe gjatë vizitës në fakultet, personeli akademik ka eksperiencë të gjatë në fushën e sigurimit të cilësisë ku shumë prej tyre kanë qënë dhe ekspertë të vlerësimit, e ka ndihmuar mjaft fakultetin të ketë një orientim të vazhduar në rritjen e cilësisë në ofrimin e programit.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka hartuar Raportin e vlerësimit, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga Agjencia e akreditimit. Ky raport përmbledh në tërësi informacionet e mbledhura gjatë këtij procesi dhe ato janë vlerësuar me standarted e ciklit të dytë për pogramet e integruara të studimit. Vlerësimet për çdo standart dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.
Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (www.ascal.al, standartet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara.
Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga PhD. Erlind Pepla ekspert dhe drejtues i GVJ, PhD. Nilena Eriksen eksperte dhe Xhiliola Bixheku, përfaqësuese e ASCAL.
Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Fakulteti për këtë proces vlerësimi. Janë vënë në dispozicion të procesit rreth 170 dokumentesi pjesë e dosjes së vlerësimit dhe ndërkohë GVJ pati mundësi të marrë mjaft informacione edhe gjat vizitës në fakultet.
Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të siguruara nga Sistemi i menaxhimit të ASCAL, informacione të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë dhe informacione të publikuara faqen zyrtare të fakultetit.

- Vizita në Fakultetin e Mjekësisë Dentare u zhvillua në datat 16 dhe 17 janar 2020 sipas një axhende gjithëpërfshirëse

Grupi i vlerësimit në këtë raport është përpjekur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit.
Një ndihmesë të madhë në finalizimin e vlerësimeve dhe gjykimeve ka dhënë vizita në institucion dhe takimet e realizuara. Vecanërisht takimet me studentët (2 takime) drejtuesit e prograit të sudimit, personelin akadmeik, kanë qënë mjaft të rëndësishme. Nga ana e FMD ka patur një angazhim maksimal në përgatitjen e vizitës, organizimin e takimeve, korrektësia në orare, infrastruktura në funksion të vizitës etj. GVJ vlerëson qasjen për tu përgjigjur pyetjeve të GVJ. Grupi i vlerësimit falenderon institucionin për angazhimin, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për dokumentet e përgatitura, stafin akademik dhe veçanërisht studentët.
GVJ shpreson që evidentimi i anëve pozitive në ofrimin e programit dhe konstatimet të evidentuara për përmirësim të mëtejshëm të tij, do të gjejë edhe dakortësimin e institucionit.

Më datë 02.03.2020, me shkresë zyrtare Nr. 2/3 Prot., datë 02.03.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 04.03.2020, përmes sistemit AMS, dërgohet

shkresa zyrtare e Institucionit, me Nr. 211/19 Prot., datë 04.03.2020, me lëndë "*Mbi Draft Raportin e vlerësimit të Jashtëm të programit të studimit të integruar të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave në Stomatologji*".

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportit, i mori në konsideratë ato duke i reflektuar ato në pjesët përkatëse të Raportit Final.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar në "Stomatologji"

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimi të lartë ofron program të integruar studimi "Master i shkencave" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i integruar i ciklit të dytë të studimit "Master në Stomatologji" ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Tiranës. Ky program ka për qëllim formimin e plotë të studentëve në fushën e stomatologjisë duke qenë në përputhje me interesat kombëtare të vendit tonë. |
| **Kriteri 2.** Programi i integruar i studimit "Master i shkencave" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit ofruar nga FMD, që nga themelimi i tij e deri më sot, duket se ka ecur në vazhdën e krijimit, konsolidimit dhe ruajtjes së vlerave akademike dhe kulturore duke përbërë një element referimi për promovimin dhe integrimin e këtyre vlerave në nivel kombëtar. |
| **Kriteri 3.** Programi i integruar i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Në bazë të misionit të institucionit dhe duke patur parasysh fushën e aktivitetit mund të themi se programi i hartuar Master në Stomatologji është në të njëjtën linjë, dhe, ka për qëllim parësor parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve në dobi të shëndetit oral si pjesë integrale e shëndetit të përgjithshëm, duke përgatitur profesionistë të aftë që të praktikojnë aftësitë e përftuara në shërbim të pacientit. |
| **Kriteri 4.** Programi i integruar i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Nxitja e zhvillimit arsimor si dhe ekonomik të një vendi vjen nga formimi cilësor i brezit të ri. Nga analizimi i përmbajtjes së programit të studimit mund të themi se ky program ofron njohuritë e duhura teorike dhe pajis studentët me aftësitë e nevojshme praktike për ta gjetur veten e tyre në tregun e punës pas mbarimit të fakultetit si dhe për të kryer rolin e tyre si kujdestarë dhe promovues të shëndetit oral dhe jo vetëm. |
| **Kriteri 5.** Programi i integruar i studimit "Master i shkencave" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor; | Mund të themi se programi i studimit Msc në Stomatologji siguron një bazë të mirë për avancimin e thellimit të njohurive edhe në ciklin e tretë të studimeve apo në specializime afatgjata. Kurikula, personeli akademik dhe infrastuktura e mundësojnë këtë proces, i cili padyshim mund të ketë nevojë të vazhdueshme për përmirësim dhe perfeksionim për t'iu adaptuar sfidave reale |

| | të kohës. | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

**Standardi I.2**
**Programi i integruar i studimit "Master i shkencave" është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | UMT ka të hartuar strategjinë e zhvillimit institucional në të cilën përfshihej edhe FMD si pjesë përbërëse e këtij institucioni. Këta elementë të zhvillimit strategjik ishin të përfshirë në programin e studimit në drejtime të ndryshme si për sa i përket përmbajtjes së programit të studimit, i cili ishte në përputhje me kërkesat dhe zhvillimet aktuale të fushës sikurse dhe zhvillimit dhe promovimit të kërkimit shkencor. |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Në statutin dhe rregulloren e institucionit ishin të përcaktuara prioritetet e ecurisë dhe zhvillimit të programeve të studimit dhe FMD dëshmoi mbi plotësimin e këtyrë prioriteve. Nga diskutimet me hallka të ndryshme të programit të studimit në nivel fakulteti, grupi vlerësues konstatoi se këto prioritete ishin në fokus të punës së institucionit me qëllim vënien e tyre në zbatim. |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Programi i studimit për vlerësim është program integruar i studimit Master i Shkencave në Stomatologji dhe inkuadrohet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Vlerësojmë se programi i përmbush kërkesat e kësaj kornize si dhe është në përputhje me formimin akademik që ofron. |
| **Kriteri 4.** Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Mendojmë se sy program studimi është hartuar dhe implementohet bazuar në objektivat dhe strategjitë e zhvillimit kombëtar të vëndit tonë dhe duke u përpjekur dhe përshtatur brenda mundësive me zhvillimet aktuale në nivel global. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi I.3**
**Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Pas analizimit të dosjes së programit GVJ evidenton se ky program ka objektiva të qarta në lidhje me formimin dhe përgatitjen e studentëve në fushën e stomatologjisë. Këto objektiva bazohen në njohuritë e thelluara teorike dhe praktike që ofrohen, për formimin e profesionistëve të aftë për t'u përballur me oportunitetet dhe sfidat aktuale të këtij profesioni. Programi synon krijimin e dentistëve me njohuri specifike të cilët ofrojnë shërbime shëndetësore të specializuara si për sa i përket parandalimit ashtu dhe trajtimit të patologjive të ndryshme orale. Njëkohësisht programi i studimit i pajis studentët që e përfundojnë atë me bazën e nevojshme për vazhdimin e formimit të tyre në nivelin e tretë të formimit siç janë doktoraturat. |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Programi i studimit ofrohet prej shumë vitesh por nuk u evidentua një informacion mbi numrin e dentistëve që ushtrojnë profesionin në vendin tonë, duke patur parasysh lëvizshmërinë e lartë të profesionistëve të fushave mjekësore, përfshirë këtu dhe stomatologjinë. Fakulteti është në komunikim me urdhërin e stomatologu i cili kryen studime zyrtare me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre. Në takimin me partnerët kjo u theksua nga përfaqësuesi i urdhërit.<br>Ajo çka u theksua edhe gjatë takimeve që GVJ realizoi ishte se pothuajes të gjithë studenten e që pqrfundonin studimet në këte program studimi licensoheshin nga Urdhëri i Stomatologut, duke dëshmuar kështu cilësinë e këtij programi studimi. |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Organizimi i programit të studimit është bërë sipas udhëzimeve përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi. Në bazë të këtyre udhëzimeve lëndët janë ndarë në *lëndë bazë, lëndë të formimit karakterizues, lëndë ndërdisiplinore /integruese dhe lëndë plotësuese.* Në përfundim të programit studentët kishin detyrimin përfundimtar në formën e provimit apo me temë diplome. Të gjitha lëndët e zhvilluara janë ndërtuar mbi bazën e Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe përmbajnë objektivat e lëndës, rezultatet e pritshme, mënyrën e realizimit dhe të vlerësimit si dhe literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar, të gjitha këto të përfshira në syllabuset e lëndëve respektive. Rishikimi i syllabuseve bëhej me një kërkesë çdo fund viti në departamentin përkatës dhe më pas ato reflektoheshin në fillim të vitit akademik. Sipas koordinatores së programit: "... pothuajse çdo vit shtohen tema të ndryshme |

| | |
|---|---|
| | në lëndë të ndryshme. Sylabuset përditësohen çdo fillim viti, por jo vetëm, pasi pedagogët mund të fusin tema të reja të cilat janë të lidhura me teknikat e reja që dalin". |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | GVJ mendon se programi i studimit në përmbajtje dhe ndërtimin e tij ka një strukturë të ngjashme me programe të tjera si brenda dhe jashtë vendit. Vlerësimi i lëndëve me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve, ECTS, është në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe lehtëson transferimin e studimeve apo ekuivalentimin e tyre në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit duke krijuar mundësi reale punësimi dhe lehtësim në transferimin e sudentëve. |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | Programi i studimit është hartuar duke përfituar nga eksperienca shumë vjeçare e institucionit në këtë profil dhe në mbështetje të objektivave dhe legjislacionit për arsimin e lartë. Organizimi i studimeve është në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara për profesionet e rregulluara në vendin tonë. |
| **Kriteri 6.** Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Gjykojmë se programi i studimit përmbledh formimin e përgjithshëm dhe atë profesional në përputhje të plotë me profilin e studimit dhe qëllimin e tij. Studentët kishin mundësinë të realizonin praktika profesionale përgjatë studimeve duke siguruar që pas përfundimit të tyre të jenë të aftë të ushtrojnë profesionin e fituar në mënyrë të pavarur dhe me profesionalizëm. |
| **Kriteri 7.** Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. | Programi i studimit është i hartuar dhe realizohej në të gjitha aspektet në gjuhën shqipe. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur grupit vlerësues nuk kishte elementë të formimit apo përgatitjes profesionale të studentëve që të ofroheshin në gjuhë të huaj, (qofshin module/leksione/seminare), pasi programi i studimit është licensuar në gjuhën shqipe dhe është në fuksion të plotësimit të nevoja kombëtare me specialist të fushës. Gjithsesi nga ana e fakultetit sigurohej mundësia e zhvillimit të leksioneve të ndryshme nga pedagogë të huaj të ftuar për studentët vendas. |
| **Kriteri 8.** Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze | Fakulteti i Mjekësisë Dentare ruan dhe depoziton dokumentacionin kryesor edhe në gjuhën angleze. Ai ruhet ne formë elektronike dhe "hard copy" duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. |
| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk** \| **Përmbushet** \| **Përmbushet** \| **Përmbushet** |

| standardit | nuk përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.4<br>Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë | Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare procesi mësimor realizohet nga personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik, personel akademik brenda UMT, lektorë të huaj dhe personel akademik më kontratë. Numri i pedagogëvë me kohë të plotë brenda fakultetit është 21, nga 7 pedagogë për secilin nga Departamentet (Departamentin e Ortopedisë, Departamentin e Terapisë dhe Departamentin e Kirurgjisë OMF dhe paraklinike) si dhe 4 personel ndihmës akademik me kohë të plotë. Numri i pedagogëve nga UMT ishte 55 lektorë dhe 17 ishin lektorë të huaj dhe 78 personel akademik me kontratë.<br>Për sa i përket personelit akademik efektiv, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, 5 mbanin titullin Profesor, 6 Profesorë të Asociuar, 8 kishin gradën PhD/Doktor i Shkencave dhe 2 ishin Msc.<br>Personeli i angazhuar në mësimdhënie kishte një eksperiencë të gjatë në procesin akademik dhe atë kërkimor shkencor. Ai disponon një aktivitet shkencor të pasur, me botime të shumta në revista si brenda dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrje aktive në konferenca të shumta me karakter shkencor. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.<br><br>**Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe | Programi i studimit Master në Stomatologji ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare, si pjesë përbërëse e Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe përputhet tërësisht me fushën akademike të këtij fakulteti, e cila ishte e përcaktuar në statutin dhe rregulloret e Universitetit dhe të Fakultetit.<br>Gjithashtu fakulteti ofron dhe dy programe të tjera studimi me drejtime specifike, specializime afatgjata dhe programet e doktoraturës po të fushës së Stomatologjisë.<br>Programi i ofruar është Program i Integruar i Ciklit të Dytë të Studimeve në përfundim të të cilit jepet titulli Master në "Stomatologji", sipas klasifikimit dhe kodimit të programeve të studimit që parashikohen nga dispozitat ligjore në fuqi. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **x** |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | FMD është i organizuar në tre departamente: Departamenti i Terapisë, Departamenti i Ortopedisë dhe Departamenti i Kirurgjisë OMF dhe paraklinike, të cilat bashkërendonin punën e tyre për të siguruar ecurinë e programit të studimit. Secili Departament drejtohej nga Përgjegjësi i Departamentit dhe kishte në përbërjen një personel akademik me kohë të plotë të përbërë prej 7 personash.<br>Në departamente organizohen mbledhje me personelin akademik, në të cilat diskutohej mbi problematika të ndryshme në lidhje me procesin mësimor. Këto problematika përcillen nëpërmjet koordinatores së programit në dekanat. Gjithashtu koordinatorja e programit përcjell në departamente edhe problematikat e studentëve që mund të kishin të bënin me orarin mësimor apo kërkesa për të zhvilluar më shumë orë praktike. Roli i koordinatores është i mirë përcaktuar.<br>Për të sigururar kontrollin e cilësisë së mësimdhënies koordinatorja e programit, e cila ishte dhe kryetare e NJSBC për fakultetin, verifikonte përputhshmërinë e realizimit të syllabuseve me orët mësimore.<br>Nga biseda me personelin akademik, ku midis tyre ishin dhe përgjegjësit e departamenteve, u evidentua se puna e tyre bazohej në 4 shtylla kryesore: mësimdhënia, kërkimi, pjesa administritive dhe puna në komunitet. Gjithashtu, nën koordinimin e departamenteve, ishin realizuar projekte të ndryshme për komunitetin, në të cilin ishin përfshirë dhe studentet. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e | Për të arritur objektivat e përcaktuar në kuadër të procesit |

| | |
|---|---|
| objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | mësimor, fakulteti dispono një sërë bashkëpunimesh me qendra spitalore, institucione arsimore apo kompani të ndryshme të fushës së shëndetësisë si dhe universitete të huaja, nëpërmjet të cilave krijohej mundësia e realizimit të aspekteve të ndryshme të procesit mësimor. Një vend të rëndësishëm në këtë drejtim luante Klinika Stomatologjike Universitare, e cila ishte mbështetja kryesore e Fakultetit për realizimin e praktikave mësimore. Në këtë klinikë studentët kishin mundësinë e realizimit të punimeve direkte mbi pacientë si pjesë thelbësore e programit të studimit si dhe pjesë të aktivitetit të tyre kërkimor shkencor. Gjithashtu Fakulteti kishte bashkëpunime dhe me klinika, qendra/kompani me profil dentar si dhe një numër të madh shoqatash kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet të cilave krijohej mundësia e njohjes së studentëve me metodat bashkëkohore në fushën e stomatologjisë, realizimit të projekteve të përbashkëta apo veprimtarive me karakter kërkimor shkencor. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Fakulteti dispon611onte marrëveshje të nënshkruara bashkëpunimi me një numër të madh klinikash dentare, institucione të tjera arsimore jo-publike, apo qendra me profil dentar ku studentët mund të njiheshin me teknologji të reja dhe aparatura bashkëkohore, apo mund të realizonin periudhën e stazhit. Praktikat mësimore dhe profesionale realizoheshin pranë Klinikës Universitare Stomatologjike, në bazë të memorandumit të bashkëpunimit midis FMD dhe KSU. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron. | Gjatë kryerjes së praktikave profesionale në kuadër të procesit mësimor, studentët punonin gjatë gjithë kohës nën mbikqyrjen e personeli akademik ose ndihmës akademik përgjegjës. Ndërkohë për studentët që kryejnë periudhën e stazhit kishte marrëveshje dhe me Universitete të tjera jo-publike të të njëjtit profil. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimoreshkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | Fakulteti dispononte ndër të tjera, bashkëpunime të rëndësishme me institucione arsimore ndërkombëtare si: Qendrën "Charite-Berlin", Universiteti Aldo Moro të Italisë, Universitetin e Chietti-Pescara, të cilat kishin si objektiva mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave nëpërmjet mobilitetit të stafeve akademike përkatëse, mobilitetit të studentëve si dhe mundësitë e realizimit të kërkimeve shkencore. |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të | Departamentet kishin të dhëna në lidhje me kërkimin shkencor të realizuar në nivel departamenti. Marrëveshjet e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | bashkëpunimit me institucionet me të cilat FMD kishte lidhje analizoheshin në mënyrë periodike. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi I.6**<br>**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | Mundësitë financiare për kërkimin shkencor në nivel Fakulteti ishin të reduktuara sipas deklarimeve të drejtuesve të institucionit dhe pjesa më e madhe e aktivitetit shkencor realizohet në mënyrë individuale nga personeli akademik i fakultetit. Gjithsesi fakulteti mundëson publikimin e rezultateve të këtij aktiviteti në Revistat Shkencore të fakultetit, të cilat botoheshin në mënyrë periodike. Në këto revista mund të publikonin rezultatet e punimeve të tyre edhe studentët.<br>Fakulteti organizonte aktivitetet e veta shkencore, ku personeli akademik dhe studentët kishin një pjesëmarrje të rëndësishme.<br>Këshilli studentor kishte një pjesëmarrje të gjerë në aktivitete të ndryshme shkencore në nivel organizativ, sikurse një pjesë e tyre angazhoheshin, nëpërmjet realizimit të temave të diplomave dhe në kërkime të mirëfillta shkencore. Kopjet të këtyre punime të diplomave ruheshin në bibliotekën e fakultetit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Ecuria e rezultateve të kërkimit shkencor ndiqej në nivel departamenti, i cili nëpërmjet raporteve vjetore analizonte aktivitetin kërkimor shkencor dhe përcillej në dekanat. Dekanati më pas nga ana e tij realizonte një raport të përbashkët për të tre departamentet. |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Rezultatet e aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik si dhe të punës së studentëve promovoheshin nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme shkencore si konferenca, etj si dhe publikimeve të rregullta në Revistat dhe Buletinët Shkencore të Fakultetit, të cilët botoheshin në mënyrë periodike.<br>Publikimet e punimeve të ndryshme të personelit akademik në revista prestigjioze dhe me faktor impakti mbetej tërësisht në iniciativën individuale të këtij personeli. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese. | Institucioni kishte politika për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në veprimtaritë kërkimore shkencore. Këta elementë ishin të mirëpërcaktuar nga kodi i etikës në rregulloren e këshillit të etikës. Gjithashtu, kjo përcillej edhe tek studentët që zhvillonin tema diploma, nëpërmjet manualit të temës së diplomës. |
| **Kriteri 5.** Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor | Fakulteti duket se i kushton vëmendje të veçantë studentëve duke i inkurajuar për pjesëmarrje në projekte të ndryshme, internship, konferenca shkencore apo aktivitete të ndryshme extrakurikulare për të rritur shkallën e përfshirjes së tyre. Për studentët që zhvillojnë tema diplome kjo është një tjetër mundësi e mirë për t'u thelluar në kërkimin shkencor. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

**Standardi II.1**

**Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit është i hartuar bazuar në dispozitat ligjore përsa i përket organizimit të tij. Ai përfshin një total prej 58 lëndësh të cilat zhvilloheshin të ndara sipas kategorizimeve të parashikuara, në lëndë të formimit bazë, të formimit kategorizues, lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë plotësuese, duke respektuar përqindjet e kërkuara për secilën prej kategorive. Për çdo lëndë kishte të përcaktuara kreditet përkatëse, të cilat ndaheshin në varësi të formave të realizimit të tyre (leksione, seminare, praktika). Në përfundim të programit studentët akumulonin një total prej 290 kreditesh dhe 10 kredite nga provimi i dipomës, gjithsej 300 kredite. |
| **Kriteri 2.** Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive | Numri i madh i lëndëve të përfshira në program (58 lëndë) |

| | |
|---|---|
| të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | krijon mundësinë e një formimi sa të përgjithshëm ashtu dhe profesional për studentët, duke i aftësuar ata pothuajse për të gjitha drejtimet apo speialitetet që mund të ofrojë profesioni i stomatologut. |
| **Kriteri 3.** Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Programi i studimit synon ofrimin e koncepteve dhe njohurive sa më bashkëkohore të fushës. Kjo ishte e dukshme nëpërmjët përmbajtjes së sylabuseve, të cilat pedagogët lektorë, në përgjithesi, i rishikonin çdo fund viti dhe aktualizonin në fillim të vitit shkollor. Literatura e përdorur ishte në gjuhën shqipe dhe kryesisht me autorë shqiptarë. Një pjesë ë mirë lëndësh, kryesisht ato me natyrë profesionale, kishin cikle leksionesh të pedagogëve lektorë, të botuara ose jo.<br>Gjatë vizitës në IAL stafi akademik konfirmoi se vazhdimisht përditësojnë literaturën në syllabuset e programit të studimit duke bëtë pjesë të saj botimeve dhe teksteve të autorëve të huaj, e cila ndikon në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit duke e bërë atë më afërt me kërkesat aktuale të tregut të punës. |
| **Kriteri 4.** Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Hartimi i programit të studimit siguron përftimin e njohurive të thella në fushën e stomatologjisë. Njëkohësisht ai u krijon studentëve mundësinë e realizimit të punimeve praktike në pacientë çka siguron përftimin e aftësive praktike të mira që gjatë periudhës së shkollimit. Nga ana tjetër mundësia e realizimit të punimeve praktike mbi pacientë, nën mbikqyrjen e stafit akademik dhe atij ndihmës, i familjarizon studentët me raste klinike reale duke i vënë përballë kompleksitetit apo nevojës për qasje ndërdisiplinore të trajnimeve dentare dhe jo vetëm. |
| **Kriteri 5.** Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.<br>**Kriteri 6.** Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit kishte të gjithë elementët që parashikon legjislacioni në fuqi (VKM Nr. 41, dt 24.01.2018), për sa i përket strukturës së tij. Në dosjen e programit të studimit ishin paraqitur plani mësimor, ku çdo lëndë kishte të përcaktuara kreditet dhe kategorizimin sipas kodeve përkatëse, formën e veprimtarive formuese (leksione, seminare, praktika) të përcaktuara me kreditet respektive, syllabuset e lëndëvë të cilat përmbanin veprimtaritë dhe objektivat formues, kontrollin e dijeve dhe mënyrën e vlerësimit.<br>Në përfundim të studimeve studentët marrin nje diplomë Master i Shkencave në Stomatologji, sipas parashikimeve ligjore, së bashku me listën e notave dhe suplementin e diplomës. Totali i krediteve të përftuara është 300 kredite. |

| | |
|---|---|
| | Në të përfshihen edhe kreditet për diplomimin. |
| **Kriteri 7.** Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj | Në programin e studimit ishin të parashikuara në përputhje me normat, numri i krediteve në lidhje më diplomimin e studentëve (10 kredite). Ajo që u konstatua nga GVJ ishte se jo të gjithë studentët përmbyllnin studimet me realizimin e një teme diplome, sipas pikës 5, Neni 75, të Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Vetëm studentët me mesatare mbi 8 mund të kryenin punim diplome. Synimi i Institucionit është që të realizojë tema diplomash sa më cilësore dhe eksperimenta për studentët, ky fakt u dëshmua edhe në takimin më studentët. Në Statutin e institucionit, neni 85 pika 2, shkronja c, lejon institucionin që të vendosë në rregulloren e vet, mënyrën e mbrojtjes së diplomës, diplome dhe / ose provim përfundimtar. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi II.2**
**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Njësia kryesore e cila ofron programin e studimit është Fakulteti i Mjekësisë Dentare. Struktura, përbërja dhe funksionimi dhe drejtimi i tij janë të përcaktuara në statutin e Universitetit (UMT) dhe janë në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Fakulteti i Mjekësisë Dentare përbëhet nga tre departamente, të cilat bashkërendojnë punën për realizimin e programit të studimit. Këto departamente janë të ndara sipas disiplinave mësimore të përafërta dhe kanë në përbërjen e tyre një personel akademik me kohë të plotë prej 7 personash. Departamenti ishte përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit akademik mësimor dhe kërkimor shkencor. Drejtuesit e departamenteve hartonin ngarkesën mësimore dhe gjithashtu përgjegjësi e departamenteve ishte rishikimi i syllabuseve, përputhshëria e personelit akademik me lëndët e zvilluara, zbatimi i orareve mësimore, shpërndarja e temave të diplomave apo organizimi dhe pjesëmarrja në projekte të ndryshme. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë | Fakulteti kishte 21 personel akademik efektiv, të përhershëm, |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.<br><br>**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | si dhe 4 personel ndihmës akademik me kohë të plotë. Numri i pedagogëve nga UMT ishte 55 lektorë, 78 ishin personel akademik me kontratë dhe 17 ishin lektorë të huaj (viti 2018-2019). Në përgjithësi (vecanërisht dy vitet e fundit në bazë të dokumentacionit të paraqitur), ishte ruajtur raporti i mbulimit të ngarkesës mësimore midis personelit efektiv dhe atij me kontratë në masën 70%, sipas kërkesave ligjore.<br>Për sa i përket nivelit të kualifikimit të personelit akademik efektiv, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, 5 mbanin titullin Profesor, 6 Profesorë të Asociuar, 8 kishin gradën PhD/Doktor i Shkencave dhe 2 ishin Msc. Lektorët e lëndëve kishin kryesisht të paktën gradën shkencore Doktor i Shkencave. CV-të e detajuara të stafit gjendeshin pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.<br>Të tre departamentet raportonin nëpërmjet raporteve vjetore në dekanat, mbi realizimin dhe ecurinë e programit të studimit, i cili nga ana e tij realizonte raportin vjetor në nivel fakulteti. |
| **Kriteri 5**. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj. | Për realizimin e plotë të programit mësimor fakulteti angazhon edhe personel ndihmës akademik efektiv veçanërisht përsa i përket praktikave mësimore dhe laboratorëve, ndonëse gjykojmë i vogël në numër (4). |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.<br><br>**Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit | Zv Dekania e fakultetit kishte njëkohësisht dhe rolin e koordinatores se fakultetit. Në këtë cilësi ajo koordinonte procesin akademik në lidhje me zhvillimin e orëve mësimore teorike dhe praktike sipas plan programit, kryente kontrolle në lidhje me cilësinë e zhvillimit të mësimit, njihej me problematikat e personelit akademik apo studentëve dhe i përcillte ato tek drejtuesi i fakultetit (Dekani), sikurse dhe adresimin e këtyre problematikave e transmeton në mbledhjet e departamenteve apo në këshillin studentor. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| |
|---|
| **Standardi II.3**<br>**Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.** |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjykojmë se Fakulteti i Mjekësisë Dentare ka një dosje të plotë të programit mësimor duke përfshirë elemntët e nevojshëm për përmbushjen e kërkesave ligjore. Fakulteti dhe departamentet kishin të përcaktuar planin mësimor të programit të studimit, objektivat dhe synimet e tij, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve, dhe personelin akademik të nevojshëm. Gjithashtu kishte të dhëna të qarta mbi kuotat e pranimeve, tarifat e studimit dhe numrin e studentëve. |
| **Kriteri 2.** Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.<br>**Kriteri 3.** Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra. | Programi i studimit ishte i strukturuar në bazë të kërkesave dhe përcaktimeve ligjore. Këto ishin të parashikuara në planin mësimor ku çdo kategori lëndësh/modulesh kishte kodin e saktë në varësi të llojit të kategorizimit. Kështu: lëndët bazë (A) = 57 kredite (19%), Lëndët e formimit karakterizuese (B) = 175,5 kredite (58,5%), Lëndët ndërdisiplinore/integruese (C) = 35,5 kredite (11.8%), Lëndët plotësuese (D) = 22 kredite (7,3%) dhe Detyrimet përmbyllëse (E) = 10 kredite (3,3%).<br>Lëndët/modulet mësimore vlerësohen me kredite. Lëndët zhvilloheshin të ndara përgjatë 5 viteve akademike me nga dy semestra për vit. Në dy vitet e para zhvilloheshin lëndët e formimit bazë dhe më pas fillonin lëndët e formimit karakterizues profesional. Në çdo vit akumulohej një total prej 60 kreditesh dhe në fund të programit nje numër prej 300 kreditesh. |
| **Kriteri 4.** Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Fakulteti disponon 'Manualin e studentit' në të cilin përfshiheshim të dhëna mbi planin mësimor, kreditet e përftuara, mënyrën e zhvillimit të lëndëvë, ngarkesën mësimore, vlerësimin e dijeve, detyrimet në lidhje me frekuentimin apo dhe strukturat mbështetëse të fakultetit për realizimin e procesit mësimor. |
| **Kriteri 5.** Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit siguronte për studentët informacionet e nevojshme në lidhje me kushtet apo kriteret e regjistrimit në program, si në rastet e aplikimeve për herë të parë ashtu dhe në rastet e transferimeve nga institucione të tjera arsimore apo ekuivalentimit të studimeve. Këto të dhëna gjendeshin dhe në rregulloren e universitetit, të fakultetit dhe të programit të studimit. |
| **Kriteri 6.** Programi i integruar i studimit përmban informacionet e | Programi i studimit disponbackte syllabuset e të gjitha lëndëve që zhvilloheshin. Kryesisht ato kishin të dhënat e kërkuara nga |

| | |
|---|---|
| nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | dispozitat ligjore në fuqi mbi emërtimin, kategorizimin, kreditet, ndarjen dhe numrin e orëve të Leksioneve, Seminareve, Laboratoreve, Paktikave si dhe mënyrën e kontrollit të dijeve, por formatimi i tyre në ndonjë rast nuk përputhej me formatimin sipas shtojcës 2, VKM Nr.41.<br>Në ndonjë rast GVJ konstaton se në syllabuset e lëndëve ishte mospërputhja midis syllabusit dhe planit mësimor për sa i përket numrit të orëve që zhvillohen (L/S) (lënda Anatomi, Biologji), moskoordinime në periudhën e zhvillimit të lëndës/modulit (Sem1/sem2) (lënda Psikiatri, Gjenetikë), apo forma të vlerësimit të dijeve me detyrë kursi kur kjo nuk është e parashikuar në plan program (lënda Pediatri), të cilat mund të jenë edhe lapsuse.<br><br>*GVJ rekomandon, një rishikim të formatimit të syllabuseve në raste kur ato nuk ishin të detajuara për t'i aktualizuar sipas kërkesave ligjore të parashikuara.* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Përmbajtja e programit rishikohej në mënyrë të përvitshme nga ana e departamenteve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. Në rastet kur ka ndryshime nën masën 20% ato përcilleshin në dekanat, i cili më pas i përcillte për miratin në Senatin Akademik. I gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion ishte në gjuhën shqipe. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Orari mësimor ishte realizuar në mënyrë që t'i përmbahej parashikimeve ligjore në lidhje me ngarkesën e studentëve. Në orar parashikohej jo më shumë se një total prej 25 orësh mësimore në javë. Konstatuam se kohëzgjatja e një ore mësimorë e dokumentuar në orar (sipas evidencës) ishte 60 minuta dhe jo 50 minuta sipas parashikimeve ligjore, çka mund të tejkalojë normën e lejuar për totalin e orëve në auditor (në veçanti në rastet kur ngarkesa javore ishte 25 orë). |

| | |
|---|---|
| | Rekomandojmë që kohëzgjatja e orës mësimore prej 50 minutash të reflektohet dhe në orar. |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Hartimi dhe përmbajtja e programit të studimit arrijnë të sigurojnë një formim të gjerë të studentëve në drejtim të fushës së studimit. Shpërndarja e lëndëve dhe zhvillimi i praktikave duke filluar nga viti i tretë, u krijonte mundësi studentëve të marrin kohën e nevojshme sikurse dhe njohuritë e duhura për të krijuar një eksperiencë që në periudhën e shkollës duke patur mundësinë e avancimit të mëtejshëm në mbarim të saj, në studime të thelluara ose punësim. |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Ndarja e lëndëve ndër vite akademike ishte e tillë që i mundësonte studentët të fitonin gradualisht konceptet themelore dhe të arrinin objektivat e programit. Gjithshtu shpërndarja e veprimtarive formuese në leksione, seminare, laboratorë apo praktika ishte bërë në mënyrë optimale për të arritur rezultatet e dëshiruara. |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i shkencave" dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Kurikula e programit të integruar Msc në "Stomatologji' është e ngjashme për nga përmbajtja me kurikula të tjera kombëtare apo ndërkombëtare. Emërtimi apo raportet teori/praktikë janë në përputhje me profilin e programit pa anashkaluar dipozitat ligjore përcaktuese. |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Në syllabuset e lëndëve ishin të përcatuara qartë ndarja mes orëve të formimit teorik, laboratorik dhe praktikës. Gjithashtu ato përcaktonin edhe objektivat e synuar të formimit për secilën lëndë. Gjykojmë se arritja e këtyre objektivave krijon kushte për transferim të studimeve apo mobilitet sikurse edhe punësim. |
| **Kriteri 6.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Ishte përgjegjësi e departamentit dhe pedagogëve të lëndëve rishikimi i syllabuseve me qëllim përditësimin e tyre, çka sipas stafit akademik bëhej në mënyrë periodike.<br>Gjithsesi literatura e detyrueshme në jo pak raste ishte cikël leksionesh i pedagogëve përkatës dhe nuk kishte informacion në lidhje me përditësimin e tyre. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë. | Gjykojmë se përmbajtja e programit të studimit siguron dhe garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të përshtatshme për një program të integruar studimi të ciklit të dytë. |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje | Gjykojmë se programi i studimit mundëson përgatitjen e individëve të aftë për t'u thelluar më tej në studime të avancuara, si specializime afatgjata apo studime doktorale. |

| | |
|---|---|
| me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Gjithashtu programi formon stomatologë të përgatitur, të gatshëm për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës. |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Fakulteti i Mjekësisë Dentare kishte një rrjet të zgjeruar bashkëpunimesh dhe partnerësh si p.sh Urdhrin e Stomatologut, apo klinika dentare, të cilat ndihmonin në një lloj orientimi drejt nevojës së tregut. Nga ana tjetër, fakti që vetë pedagogët janë dhe ushtrues të këtij profesioni bën që të kuptojnë nga afër kushtet e zhvillimit të tij në vendin tonë dhe të kuptojnë prioritetet se drejt ku duhet shkuar. |
| **Kriteri 10.** Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve | Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor krijon mundësinë e përftimit të njohurive më të avancuara për të gjithë studentët e këtij programi studimi. Duke i dhenë atyre mundësinë që të thellojnë më tej studimet e tyre edhe në programet e ciklit të tretë, Doktoratura dhe Specializime afatjata. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. | Sipas udhëzimeve ligjore në fuqi, ngarkesa e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në një program studimi duhet të jetë për PAE: 140/165/195 dhe PAK 120/120/120 për kategoritë Profesor/Lektor/Asistent Lektor, ndërsa për personelin akademik që janë dhe autoritete drejtuese normat janë 70/90/90 për pozicionet Dekan/Zv.Dekan/Përgjegjës Departamenti. GVJ konstaton se IAL zbaton udhëzimin Nr.29/2018 të MASR për të përcaktuar ngarkesës e stafit akademik. Stafi akademik me kohë të plotë ka të drejtë të mbuloj 200 orë plus mbi ngarkesën vjetore. Stafi akdemik nuk e tejkolonte normën e ngarkesës mësimore, e cili ishtë e ndarë në orë lexione/seminarë/laboratore dhe udhëheqje diplomash. Gjithashtu edhe numri i lëndëve që mbulonin ishte në përputhjë më këtë udhëzim. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, | Pjesa më e madhe e programit të studimit mbulohej nga |

| | |
|---|---|
| që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | personeli akademik me kohë të plotë. Numri i përgjithshëm i PAE ishte 25 nga të cilët 21 ishin personel akademik dhe 4 ishin personel ndihmës akademik. Personeli akademik kishte një formim tejet të konsoliduar si dhe një eksperiencë shumë të gjatë në mësimdhënie. Njëkohësisht kishin një investim të vazhdueshëm në drejtim të kërkimit shkencor duke qenë pjesëmarrës dhe organizues të një sërë aktivitetesh shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe botues të një numri të madh artikujsh shkencorë apo monografish, duke qenë figura të rëndësishme të fushës së stomatologjisë në vendin tonë. Në programin e studimit Master i Shkencave në Stomatologji, të FMD, ishin të angazhuar 5 Profesorë, 6 Profesorë të Asociuar, 8 kishin gradën Doktor i Shkencave dhe 2 kishin Master Shkencor, të cilët kishin kualifikimin e nevojshëm për të mbuluar organizimin dhe ecurinë e programit të studimit.<br>Personeli akademik me kontratë i angazhuar në program kishte kryesisht gradën Master Shkencor dhe në disa raste Doktor i Shkencave apo Profesor i Asociuar. |
| **Kriteri 3.** Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Fusha akademike e personelit të angazhuar ishte në përputhje me lëndët/modulet specifike që ata mbulonin në kuadër të programit të studimit. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një ekperiencë të gjatë në fushën e stomatologjisë. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Fakulteti i Mjekësisë Dentare, duke qenë dhe një institucion publik, kishte mbështetjen dhe gëzonte bashkëpunimin e një sërë qendrash apo institucionesh arsimore dhe mjekësore. Një mbështetje e rëndësishme ishte Klinika Universitare Stomatologjike, ku studentët kryenin pjesën praktike të formimit të tyre. Klinika siguronte personel të kualifikuar dhe me formimin e nevojshëm akademik për të ndjekur praktikat profesionale të studentëve. Gjithashtu pjesa klinike mbulohej edhe nga bashkëpunimi me QSUT "Nënë Tereza" dhe spitalin francez pranë kësaj qendre. Për pjesën e laboratoreve për lëndët e formimit të përgjithshëm, FMD kishte marrëveshje bashkëpunimi me FSHN, apo shfrytëzonte ambjentet e UMT si dhe personelin e tij ndihmës mësimor për realizimin e këtyre orëve.<br>Për ndjekjen e punimeve të diplomave ishte i angazhuar vetëm personeli akademik efektiv i fakultetit, i cili synonte realizimin |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | e temave kryesisht praktike apo eksperimentale, duke shfrytëzuar ambjentet dhe kapacitetet e sipërpërmendura. | | | |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit | Fakulteti ka një numër të vogël përsoneli ndihmës mësimor me kohë të plotë (4) brenda tij, i cili është i angazhuar në procesin mësimor dhe kërkimor. Njëkohësisht fakulteti ka në dispozicion dhe personel ndihmës mësimor nga KSU, e cila është një strukturë universitare dhe ka kapacitetet e mbështetjes me personel të kualifikuar. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Fakulteti, sikurse kemi përmendur edhe më lart, kishte një bashkëpunim dhe partneritet të gjerë me institucione të ndryshme, ku një nga qëllimet e këtyre bashkëpunimeve ishte dhe mbledhja e informacioneve në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Këto informacione vinin përmes zërit të pedagogëve apo bashkëpunëtorëve dhe diskutoheshin në departamente. Më pas, nëse kishte propozime konkrete për ndryshime në planin mësimor, këto përcilleshin për miratim drejt organeve drejtuese të fakultetit siç është Dekanati, Drejtorisë së Kurikulave e më pas bëheshin subjekt i vendimmarrjes në Senatin Akademik. |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | Një zë i rëndësishëm ishte dhe ai i studentëve, të cilët diskutonin dhe angazhoheshin në mënyrë aktive në konsultimet për ndryshimet dhe përmirësimet në përmbajtjen dhe mënyrën e zhvillimit të programit. Ata ishin të organizuar në Këshillin Studentor, i cili i diskutonte këto aspekte në departamente apo dekanat. Bazuar në diskutimet direkte me studentët, ata ishin të vetëdijshëm për rolin e tyre në përmirësimin e programit të studimit dhe dëshmuar se zëri i tyre dëgjohej në fakultet pëe aspekte që lidhen me mësimdhënien, tematikat e syllabuseve, oraret apo kontestimet e notave të provimeve. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. | Sipas drejtuesve të institucionit, ky i fundit ruan kontaktet me studentët e diplomuar. Një pjesë e tyre marrin pjesë edhe në aktivitetet shkencore që organizon fakulteti, sikundër eksperiencat e tyre profesionale ose akademike brenda ose jashtë vendit i ndajnë me institucionin me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi. | Në sajë të marrëveshjes të bashkëpunimit që FMD kishte me institucione jashtë vendit (Instituti Charite-Berlin) po bëhej e mundur implementimi i një projekti, i cili kishin në objektiv përdorimin e aparaturave kompjuterike dixhitale në përgatitjet laboratorike të punimeve protetike. Kjo kishte nxitur përfshirjen e një lënde të re në planin mësimor 2019-2024 siç ishte Dentistria Inovative.<br>Gjithashtu, FMD në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë kishte ndërmarrë nje fushatë ndërgjegjësimi të popullatës mbi shëndetin oral, e cila konsistonte në informimin dhe ofrimin e shërbimeve dentare falas në shkollat e Tiranës nga studentët e fakultetit.<br>Gjykojmë se aktivitete apo projekte të tilla vijnë në ndihmë procesit të formimit, zhvillimit dhe profesionalizimit të studentëve, sikurse ndihmojne institucionin për të kuptuar nivelin dhe lartësuar objektivat formues të programit të studimit. |
| **Kriteri 5.** Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme | Sikundër kemi përmendur edhe më lart, komunikimi i vazhdueshëm me rrjete profesionistësh, shoqata të ndryshme, Urdhrin e Stomatologut, apo institucione publike dhe private mund ta ndihmojë FMD në perfeksionimin e programit të saj të studimit, për ta bërë sa më bashkëkohor dhe kompetitiv në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe | Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat e tij, në lidhje me formimin e përgjithshëm teorik, aftesimin praktik dhe |

| | |
|---|---|
| kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | krijimin e bazave për thellimin në studime të mëtejshme akademike apo kërkimin shkencor. Këto objektiva ishin në përputhje dhe me objektivat primarë të institucionit. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Njësitë bazë (departamentet) ishin përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit akademik mësimor. Ato ndiqnin nga afër zhvillimin dhe realizimin e lëndëve, kishin kontakte me personelin akademik, adresonin problematika të ndryshme të studentëve si dhe koordinonin veprimtaritë kërkimore të personelit mësimdhënës. Aktiviteti i të tre departamenteve bashkrendohej nga njësia kryesore, që ishte Dekanati dhe Dekania e fakultetit. Organizimi i veprimtarive kërkimore dhe shkencore drejtohej nga njësia kryesore. Nën kujdesin e njësisë kryesore nxiteshin departamentet për pjesëmarrjen në veprimtari shkencore si në nivel individual të stafit akademik, duke respektuar lirinë akademike, ashtu dhe në ato që organizonte fakulteti apo shoqata të specialitetit me të cilat fakulteti bashkëpunon apo ka partneritet/aderon. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Sikundër dëshmuan edhe vetë studentët, gjatë bashkëbisedimit në takim, ata stimuloheshin të merrnin pjesë në aktivitetet e ndryshme që organizonte fakulteti. Angazhimi i tyre ishte në forma të ndryshme. Një pjesë e madhe përfshihej në aspektin organizativ të aktiviteteve shkencore, sikurse një pjesë tjetër, kryesisht studentë të viteve të fundit përfshiheshin nga pedagogët në studime apo projekte të ndryshme, rezultatet e të cilave paraqiteshin në këto evente shkencore. Për sa i përket studentëve me mesatare të lartë, ata kishin mundësinë të kryenin studime të mirëfillta shkencore, në kuadër të zhvillimit të temës së diplomës dhe punimet që vlerësoheshim si më cilësoret, publikoheshin në revistat e fakultetit. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare dhe duhet të dëshmojë lidhje me hartimin e këtyre politikave |
| **Kriteri 5.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | Mbështetja financiare e kufizuar nga ana e fakultetit për personelin, u theksua në takimin me personelin akademik dhe drejtues të njësive bazë. Sipas tyre mungojnë fondet për të nxitur dhe stimuluar kërkimin shkencor apo rritjen profesionale të pedagogëve për shkak të kufizimeve ligjore. Përditësimi me të rejat e fundit si në teknologji dhe aparatura bëhet me iniciativa personale të pedagogëve për të qenë në një hap me kohën. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Një pjesë e stafit kishte përfituar nga projektet Erasmus, sikurse dhe disa studentë ishin bërë pjesë e këtyre projekteve. Institucioni synonte mbështetje financiare dhe nga burime të tjera si projekte, donacione apo shërbim ndaj të tretëve. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Fakulteti në sajë të bashkëpunimeve me institucione të huaja që shërbejnë dhe si qendra kërkimore shkencore (Charite-Berlin, etj), kishte mundësuar zhvillimin e leksioneve të hapura, ku staf i këtyre institucioneve kishte prezantuar të rejat e fundit e fushës apo zhvilluar ëorkshope nga të cilat kishin përfituar një numër i lartë studentësh.<br>Njëkohësisht institucioni kishte bashkëpunuar dhe vazhdon të bashkëpunojë me institucione të tjera si për shembull kompaninë Ivoclar, nëpërmjet të cilës studentët janë njohur me teknologjitë më të fundit në fushën e stomatologjisë, si pjesë përbërëse e formimit të tyre. Këto bashkëpunime dhe njohuri mendojmë se mund të nxisin stafin si dhe studentët për përfshirje në kërkim shkencor. Organizimi i eventeve shkencore të rëndësishme me pjesëmarrje kombëtare dhe ndërkombëtare, ndihmonte stafin akademik por edhe studentët në ndarjen dhe shkëmbimin e eksperiencave me kolegë apo profesionistë të fushës. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Fakulteti dhe drejtuesit e tij kishin angazhimin e plotë për t'iu përgjigjur kërkesave për studime, analiza apo projekte me karakter shkencor. Ajo që konstatojme dhe që na u konfirmua gjatë takimeve, është se mbështetja e munguar apo shumë e vogël nga ana financiare është një element shumë i rëndësishëm për motivimin e personelit akademik për një përfshirje në këto iniciativa. Gjithsesi GVJ vlerëson përkushtimin dhe angazhimin brenda mundësive të stafit akademik dhe mbështetjen që i akordon studentëve për të realizuar objektivat e programit. |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët | Sikurse kemi përmendur dhe më lart, fakulteti organizon konferenca të përvitshme shkencore, dhe aktivitete të tjera me karakter mësimor dhe shkencor, të cilat ndihmojnë në formimin |

| | |
|---|---|
| për arritjen e objektivave | e vazhdueshëm të stafit akademik dhe plotësojnë objektivat e programit të studimit në lidhje me formimin dhe përgatitjen e gjithanshme të studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

**Standardi III.1**
**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe takimin me stafin akademik (T6) rezulton se insitucioni përdor një sërë metodash mësimdhënëse ku për shkak të specifikës së vecantë që ka ky insitucion përvec metodës tradicionale të mësimdhënies një rëndësi të vecantë i kushtohet praktikës lëndore dhe profesionale, përdorimit të teknologjisë së fundit etj. (Rregullore e Programit te Studimit). |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik realizohet në mënyrë periodike (rregullore NJSBC) nga NJSBC në nivel institucional ndërsa në nivel fakulteti, ky proces monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga njësitë bazë dhe nga Dekanati (Rregullore fmd). Referuar takimit që GVJ zhvilloi me NJSBC (T9) e fakultetit dhe universitetit (T7) rezulton se kjo njësi realizon në mënyre të vazhdueshme monitorimin e programit të studimit me anë të pyetësorëve të studentëve të cilet realizohen dy herë në vit ku ata shprehen mbi cilësinë e mësimdhenie, si dhe duke kontrolluar cdo fund viti realizimin e planit vjetor të pedagogëve etj. Edhe në takimet me student, u evidentua një fakt i tillë. (T4&5). Fakulteti përmirëson në mënyrë të vazhdueshme metodat e mësimdhënies duke respektuar dhe |

| | |
|---|---|
| | lirinë akademike (programi, metodat e mësimdhënies) |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Nga takimi (T4&5) që GVJ realizoi me studentët rezulton se (T4), UMT nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Cilësisë me anë te pyetësorit që realizohet dy here në vit u jep mundesinë studentëve të japin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhenies. Një tjetër instrument që UMT përdor për këtë qëllim është Këshilli Studentor ku studentët diskutojnë problemet e tyre qe lidhen me programin e studimit dhe i adresojnë ato në Fakultet nëpërmjet perfaqësuesit të këshillit studentor. Ndërkohë prezenca e drejtuesit studentor në mbledhjet e dekanatit dhe kontakti me koordinatorin e programit, mundëson, përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Ankimimi dhe rishikimi i vlerësimit është garantuar në rregulloren e fakultetit, programit të studimit (rregullore) |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | NJSBC si struktura përgjegjëse (organigrama UMT) për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, bën përpunimin e pyetësorve të studentëve, formularin e përformancës së lëktorëve, harton raporte mbi rezultatet e vlerësimit të programit të studimit të cilat i përcillen zv.Rektorit për anën mësimore si dhe cdo dy vite harton raportin e vlerësimit të brëndshëm të cilësisë në nivel insitucional të cilin ja përcjell Rektorit të universitetit dhe Senatit Akademik , këto rezultate behën publike nga NJSBC (Rregullore e NJSBC). Referua dokumentacionit të vënë në dispozicion, (raportet vjetore), vetë departamentet monitorojnë mësimdhënien dhe veprimtaritë e tjera të personelit akademik dhe ndihmësakademik në funksion të saj. Procesi kryhet gjatë gjithë vitit akademik ku monitotohet zhvillimi i procesit mësimor, korrektësia e mësimdhënies, testimeve/provimeve etj (relacione për mësimdhënien). Edhe drejtuesit e fakultetit, nëpërmjet sekretarisë mësimore ose grupeve ad-hoc, ndjekin në mënyrë të vazhdueshme respektimin e orarit mësimor dhe zhvillimin e programit të studimit në përputhje me programin e miratuar (vlerësim personeli).<br>Në takimin me stafin akademik (T6)u evidentua se në mënyrë periodike ata raportojnë në departament dhe departamentet në dekanat mbi zhvillimin dhe ecurinë e procesit mësimor. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon | Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik të programit (T6) rezulton se FMD nxit stafin akademik për humultimin e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies | zbulimin e metodave innovative të mësimdhënies në fushën e dentistrisë duke i mundesuar pjesëmarrjen në kongrese, konferenca apo ëorkshop-e të ndryshme si dhe exchange në kuadër të programit ERASMUS +. (Lista e Shkembimeve Ndërkombëtare të UMT; Kongresi i Stomatologjisë; Kongresi i Ballkanit). Shembujt e praktikave të mira në kuadër të mësimdhënies dhe studentët me rezultate të larta, gjithnjë janë mbështetur dhe promovuar jo vetëm duke i prezantuar ata në evente të ndryshme që realizon fakulteti, por ka akorduar dhe çmime të ndryshme në respekt të punës dhe përkushtimit të tyre (Manuali i studentit) | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përm bushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Përmbajtja e programit të studimit (programi 18-23) është një dokument prej 250 faqesh dhe përmban informacione të detajuara në lidhje me organizimin e programit. Bazuar në syllabuset e lëndeve rezulton se pedagoget e realizojnë lëndën në bazë të seminareve, orëve të laboratorit, leksioneve, projekteve, detyrave të kursit, praktikës profesionale në klinika dentare, si dhe provimeve. (Syllabuset). Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët janë të shumta dhe në varësi të llojit/ specifikës së veprimtarive formuese por edhe lirisë së veprimit që ka personeli për zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies/<br>Ndërthurja e teroisë me praktikën është evidente në pothuaj të gjitha lëndët/modulet e formimit bazë dhe specifik. Ndërsa përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre bëhet në mënyrë të vazhdueshme (T4&5), mundëson realizimin e veprimtarive sipas parashikimeve. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të | Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik (T7), studentët (T4&5), shqyrtimit të CV- të stafit akademik (CV-të e stafit)., rezulton se personeli akademik i programit të integruar të studimit Msc Stomatologji është i përgatitur dhe ka kualifikimet e duhura për ti ofruar në mënyrë të diversifikuar dije studentëve |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | në lidhje me patologjitë e ndryshme në fushën e stomatologjisë duke ndërthurur dijet teorike me ato praktike. Nga takimi me studentët (T4&5) GVJ u informua se ata përfshihen nga stafi akademik në kuadër të përmirësimit të orës së mësimit. Fakulteti disponon infrastrukturë cilësore në funksion të realizimin të procesit mësimor. Fakulteti është rikontruktura në 2007 dhe është pajisur mjetet e nevojshme didaktike e laboratorike. Sallat kryesore janë pajisura me sistem audio-vizive (projektorë) ndërsa laboratorët me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e praktikave mësimore e profesionale.<br><br>Nga takimi me drejtuesin e fakultetit (T1) por edhe nga takimi me studentët (T4&5) u evidentua nevoja e rritjes së kapaciteteve të fakultetit, veçanërisht auditorë për leksione. (të dhëna për infrastrukturën) |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Stafi akademik në programin e studimit ka eksperincë të gjatë në mësimdhënie (cv e stafit). Bazuar në takimin qe GVJ realizoi me stafin akademik (T6) u informua se FMD nxit personelin e tij akademik në marrjen pjesë në konferenca apo ëorkshopeve të cilat u shërbejnë atyre për të përmirësuar kompetencat didaktike. Format mësimëdhënëse të programit janë të ndryshme duke përfshirë seminaret, leksionet, punët laboratorike, detyrat dhe projektet e kursit, praktikën profesionale, duke qënë kështu në përputhje me parshikimet e VKM 41/2018. Këto metoda të mësimdhënies dhe mësimnxëniës do ti aftësojnë studentët me njohuritë e duhura për tu përballur më pas pas mbarimit të studimeve me tregun e punës. Insitucioni ve në dispocion të studentëve dhe stafit akademik Klinikën Universitare Stomatologjike, e cila shërben për praktikimin e studenteve dhe qasjen direkte me pacientin. (Infrastruktura KSU).<br>Grupi i punës vlerëson mjaft pozitive metodat didaktike të praktikës profesionale të cilat zhvillohen nga studentët në pacientë realë (T4) |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Bazuar në CV-të e secilit prej stafit akademik të programit rezulton se stafi është në përputhje me fushën e mësimdhënies dhe ka kompetencat dhe aftësitë e duhura për të përcjellë tëk studentët dijet e nevojshmë në kuadër të fushës së studimit. (CV e personelit akademik). Shumica e tyre kanë eksperiencë shumëvjeçare në mësimdhënie dhe kërkim dhe janë angazhuar edhe si ekspertë nga ASCAL. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5**. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.<br><br>**Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Personeli akademik është gjithmonë i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti (programi), (T4&5). Eksperienca shumëvjeçare e personelit akadmemik është e ndërthurur me personelin e ri duke mundësuar në këtë mënyrë vijueshmëri të traditës së krijuar por njëkohësisht implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. UMT përmës NJSBC realizon anketa semestrale me studentët për procesin e mësimdhënies, ku nësë hasen pakënaqësi ose sugjerime për të përmirësuar mësimdhenien, sic ju komunikua GVJ-së nga studentët, ato meren parsysh. Gjithashtu NJSBC në kuadër të përmirësimit të stafit i cili është ndërthurur nga staf më përovje dhe staf i ri, analizon në fund të viti akademik fomrularin e plotësuar nga vetë stafi akademik mbi realizimin e pritshmërive. (Takimi me NJSBC; anketat e studenteve; formulari i pedagogeve).<br>Ndërkohë format e kontrollit të dijeve bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar të lëndës /modulit/ programit: testimet ndërmjetëse, vlerësimi i praktikave laboratorike, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të ndryshme, provimi përfundimtar, mbrojtja e temave të diplomave.<br>Bazuar në takimin që GVJ realizoi me stafin akademik ***(T6),*** rezulton se ata përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies duke e integruar teorinë me rastet praktike të pacienteve, projektet e kursit, detyrat e kursit etj. Të gjitha format dhe metodat të mësimdhënies të të parashikuara në programin e studimit (***programi i studimit***), zbatohen në funksion të përgatitjes së studentit me aftësitë profesionale. Si personeli akademik edhe strukturat përgjegjëse, janë të angazhuar maksimalisht që studenti në përfundim të studimeve të tij të dëshmojë se zotëron këto njohuri, aftësi dhe kompetenca dhe të jetë profesionist i vërtetë në fushën e vet.<br>Nga studentët u theksua një përmirësim në infrastrukturën e librarive on line ku pedagogët dhe studentët mund të shfrytëzojnë libraritë on-line si dhe botimet shkencore të universitetit. ***(T4&5)*** Në libraritë on line të fakultetit studentët mund të konsultojnë libra nga fusha të ndryshme të mjekësisë dentare etj. (***materiali biblioteka, libraritë on line)*** |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e | Në programin e intengruar të studimit Msc Stomatologji, |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | studentët kalojnë një pjësë të mirë të tyre në laboratore duke kryer praktikën profesionale apo me detyra apo projekte kursi ***(programi, plani mësimor)***. Studentët dëshmojnë se nxiten nga stafi akademik për të qënë të pavaruar nën mbikëqyrjen e tyre. ***(Syllabuset).*** Ndërkohë rezulton se personeli akademik është gjithmonë i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me programin e studimit. Eksperienca shumëvjeçare e personelit akadmemik është e ndërthurur me personelin e ri duke mundësuar në këtë mënyrë vijueshmëri të traditës së krijuar por njëkohësisht implementimin e metodave të reja të mësimdhenies.<br>Nga takimi me personelin akademik, rezulton se ata janë të angazhuar të sigurojnë infrastrukturën e duhur mësimore/laboratorike, tekstet mësimore dhe materiale të tjera ndihmëse në funksion të studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Bazuar në RVB, ***(RVB faqe 39-40), (vizita e ambienteve)*** FMD si njësia kryesore përgjegjëse për realizimin e programit të studimit ka në dispozicion për realizimin e mësidhënies: "2 salla leksionesh, 13 salla klinike në të cilën studentët zhvillojnë seancat e praktikave me pacientët në lëndët e Kirurgjise orale, Ortopedia stomatologjike, Ortodoncia, Terapia Stomatologjike, Periodontologjia dhe Dentistria Pediatrike, 3 salla paraklinike ku realizohet lëndët paraklinike të Terapisë, Ortopedisë dhe ortodoncisë, 2 laboratore për përgatitjen e punimeve protetike, 4 salla për realizimin e lëndës së Kirurgjise Maxillo Faciale në Spitalin Francez, ambjente zyrash për stafin administrativ, ambjente zyrash për shefat e departamenteve, ambjente zyrash për sekretarinë mësimore, sallë bibliotekë (infrastruktura).<br>Ambientet rezulton që mirëmbahen, janë të pastra dhe ofrojnë mjedis të përshtatshëm pune për stafin dhe mësimor për |

Adresa: "Rruga e Durrësit",
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | studentët.<br>Megjithatë, si nga stafi edhe nga studentët, u evidentua nevoja e rritjes së kapaciteteve të fakultetit. Në takimin me personelin administrativ, u theksua përpjekja që është duke zhvilluar fakulteti për ndërtimin e një shtese në godinën aktuale të FMD. Pavarësisht përpjekjeve (ende nuk ka fakte konkrete të realizimit të këtij projekti) dhe propozon që fakulteti të intesifikojë përpjekjet për të realizuar sa më parë këtë objektiv. |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave. | Nga vizita që GVJ realizoi në ambjentet e FMD (***vizita në institucion***) rezulton se ato janë të mjaftushme për mbarëvajtjen me sukses të procesit mësimor, duke patur salla të pajisura me projektorë, dhe kompjutera, laboratorë dentarë si dhe salla klinike si për realizmin e lëndëve kirurgjikale (infrastruktura ***e fakultetit dhe universitetit***). Në mjediset e fakultetit funksionon Klinika stomatologjike universitare që shërben në realizimin e praktikave me studentët (***infrastruktura KSU***) |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | Bazuar në RVB (***faqe 40***) dhe vizitës që GVJ realizoi në insitucion rezulton së FMD në bashkëpunim me RASH (***Rjeti Akademik Shqiptar***) i mundëson personelit akademik dhe studentëve, Sistemin e Menaxhimit. Gjitashtu FMD disponon ëi-fi në të gjitha ambjentët ku zhvillohet mësimi dhe laboratore kompjuterikë që i shërbejnë personelit akademik për punën kërkimore shkencore dhe studentëve për realizimin e projekteve apo detyrave të kursit.<br>Studentët përdorin bibliotekën e fakultetit për akses në libraritë on linë dh edokumente të tjera. Stafi dhe studentët kanë akses në llogaritë e tyre të sistemit RASH. ***(T4&5)*** |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Nga shqyrtimi i syllabuseve rezulton se literatura është kryesisht ajo e viteve të fudit dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme (programi, syllabuset). Literatura është kryesisht në gjuhën shqipe përjashtuar rasteve kur rekomandohen libra elektronikë. Mjediset e bibliotekës (GVJ realizoi takimet në ambientet e bibliotekës) janë të vogla por të pajisura dhe të pastra. Studentët deklaruan se ata përdorin bibliotekat e tjera të universitetit dhe libraritë elektronike. (T4&5) |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Bazuar në RVB rezulton se *fondi aktual i bibliotekës është fokusuar tërësisht në fushën e stomatologjisë pasi botimet e tjera studentët i aksesojnë në bibliotekën e universitetit. Aktualisht në bibliotekë gjenden rreth 179 libra dhe 250 revista stomatologjike. Revistat janë të karakterit periodik dhe datojnë* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | *që para viteve 90 e deri në vitin 2007.* Bibloteka ofron 30 poste leximi për studentët e programit të studimit. (***Syllabuset; informacion për bibliotekën***)<br>Sipas RVB dhe takimit me studentat (***faqe 41***), UMT, ka vënë në dispozicion libraritë on line me akses të plotë për personelin akademik dhe studentët në të cilat mund të aksesohen COLIB, CONOR, SGC, botimet elektronike me regjistrimet në COBIS etj.<br><br>Nga MASR, u vu në dispozicion të institucioneve shqiptare, bibloteka on line nga RASH (***U-library***) ku personeli akademik ka akses nëpërmjet llogarive personale që UMT mundëson për akses në Sistemin e Menaxhimit.<br>Ndërkohë në marrveshjet e bashkëpunimit që fakulteti ka lidhur, personeli mund të shfrytëzojë edhe biblotekat dhe infrastrukturën e partnerëve. |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | FMD në funksion të realizimit të praktikave të studentëve, punëve laboratorike apo detyrave të kursit ve në dispozicion të studentëve laboratorë dhe Klinikën Stomatologjike Universitare (***infrastruktura, KSU***).<br>Disa nga studentët deklaruan se shfrytëzojnë njohjet e tyre po institucionet si dhe klinika dentare private, me të cilat fakulteti ka marrëveshje. (***T4***)<br>Studentët deklaruan se ndihmohen ng astafi për të patur mundësi të angazhohen në institucionet private arsimore ku fakulteti ka marrveshje si dhe kllinika. (***Marrevesshje me Insitucionie Kombëtare: Marrëveshja me klinikën Advantage***) |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Bazuar në takimin që GVJ realizoi me stafin akademik u informua se ata përdorini platformat për akesimin e botimeve eltronike (***RVB faqe 41***).<br>Interesant është fakti i përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies si aplikimi i Moodle nga universiteti e cila pavarësisht se është në fazën e parë të zbatimit në bashkëpunim me RASH, konsiderohet një aspekt pozitiv. (platforma e edukimit)<br><br>Në shpërndarjen e informacionit, ruajtjes së të dhënave, menaxhimit të projekteve apo grupeve të punës, përdoren gjërësisht e-mailet të ofruar nga institucioni, platforma on line apo teknologji të reja komunikimi, rrejte sociale etj. (***T4&5***) |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Të dhënat në lidhje me leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund të kryejnë nëpërmjet sistemit të menaxhimit ESSE3 (***manuali i sistemit***) platformës google classrom etj. Referuar RVB (***faqe 42***) dhe takimeve të zhvilluara rezulton se stafi akademik dhe studentët përdorin sistemin e brendshëm ESSE3 dhe platformen google classrom për komunikimit e brëndshem mes tyre në lidhje me detyrat, leksionet, si dhe materialet e tjera të nevojshme për mësimdhënien dhe mësimnxënien.<br>(***Manuali i Sistemit ESSE3***). |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Në programin e studimit MSc. Stomatologji, bazuar në statutin e instiutcionit, rregulloren e programit të studimit, studenti ka të drejtë të shlyejë provimin final në dy mënyra (statuti, rregullorja e programit): me provim me shkrim nëse ka shlyer të gjitha detyrimet, me temë diplomë nëse mesatarja e studimeve është mbi 8 dhe studenti përzgjedh këtë formë të mbrojtjes sës diplomës.<br>Ndëkohë Ligjin e arsimit të lartë, diplomimi i studentëve të ciklit të dytë bëhet me mbrojtje diplome çka tregon se kemi një paqartësi në mënyrën e realizimit të këtij procesi.<br>Çdo vit akademik, dekanati miraton procedurën që ndiqet në lidhje me të gjitha hapat e realizimit dhe mbrojtjes së të temës së diplomës (***rregullore diplomimi***). Bazuar në rregulloren e programit të studimit, rezulton se studentët e këtij programi kanë të drejtë mund të diplomohen me anë të një provimi final ose në rastet kur studenti ka mesataren mbi 8 ka të drejtë të zgjedhë të diplomohet me teme diplome ose provim. (***lista e studentëve për diplomë***).<br>Në secilin rast, studenti ka informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe realizimin e tij.<br>Në rastin kur studenti zgjedh të diplomohet me teme diplome ai asistohet vahdimisht nga një pedagog gjatë punimit të temës së diplomës. (***T4&5***).<br>Mospërputhjen me detyrimin ligjor për mbrojtjen diplomës me temë për programet master shkencor, është diskutuar (***T2, 3, 4, 5***) me të gjithë takimet që zhvilloi GVJ dhe argumentimi i institucionit ka qënën për të krijuar një standart cilësor në diplomat që hartohen nga studentët dhe ky qëllim është vendosur edhe në statutin e UMT (statuti). |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.4<br>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | UMT ashtu sic e parashikon edhe ligji 80/2015 ka ngritur me Urdhër 189 dt.16.05.17 Njësinë e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë *(organigrama)*. Fakulteti ka njësinë e vet të përbërë nga 6 antarë dhe 1 Kryetar e cila ka për detyrë sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e veprimtarisë kërkimore shkencore si dhe kontrollin e funksionimit administrative (Rregullorja e NJSBC). Zyra në nivel universiteti përgatit raporte periodike, dhe vjetore të cilat ia vë në dispozicion Rektorit dhe Senatit akademik. Ndërkohë njësia e fakultetit bashkërendon punën me strukturën qëndrore dhe njëkohësisht informon Dekanin e Fakultetit. ***(Takimi me njësinë, Rregullore e NJSBC; Urdhëri për Ngritjen e NJSBC)*** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron. | Referuar Statutit, Rregullores së UMT (***statut, rregullore***) si dhe në RVB, rezulton se fakulteti dhe departamentet janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në programin e studimit. Më shumë se një detyrim ligjor, ky proces gjithnjë e më shumë po zhvillohet në funksion të promovimit dhe ndërgjegjësimit të të gjithë personelit të FMD në lidhje me cilësinë. Gjithashtu për sigurimin e cilësisë në procesin mëvsimor zv. Dekani i ngarkuar për pjesën mësimore, koordinatori i programit ***(T2)***, sipas një plani të përcaktuar, organizon takime dhe konsultime me përgjegjësit e departamenteve në të cilat diskutohet mbi ecurinë e procesit mësimor sipas lëndëve dhe viteve, problematikave të ngritura nga studentët apo dhe pedagogët duke gjetur zgjidhje me qëllim sigurimin me korrektesë të mbarëvajtjes së procesit mesimor. Gjithashtu në këto takime përcaktohen dhe detyrat që parashikohen të realizohen në afatet e përcaktuara" |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Universiteti dhe fakulteti mbështësin stafin akademik në aktivitetin e tyre kërikimor shkencor i cili çon më pas edhe në përvetësimin e stafit të metodave të reja të mësimdhënies.<br>Disa nga aktivitet kërkimorë shkencore që ka realizuar stafi |

| | |
|---|---|
| | janë: Konferenca 22 Kombëtare Dentare, e mbajtur në tetor në Tiranë; International congress of Albanian Dental Society, i mbajtur ne muajin maj 2016 në Strugë etj. (***Veprimtaria Kërkimore Shkencore e Stafit 2016-2019). (RVB faqe 44***) |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Bazuar në dokumentin *"Lista e aktiviteteve" dhe "Aktiviteti Shkencor"* por edhe nga takimi që GVJ realizoi me dekanin dhe stafin akademik reazulton se, programi i integruar i studimit Msc Stomatologji ofrohet në rang Fakulteti dhe si i tillë stafi akdemik ka një larmishmëri fushash dhe përvojash të fituara edhe gjatë mobiliteteve te stafit që i mundëson FMD, FMD gjithashtu organizon ëorkshope, kongrese, orë të hapura ku stafi akademik ka mundësinë e përmirësimit të njohurive dhe aftësimin me metoda të reja mësimdhënëse. |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik ***(T6)*** dhe studentët ***(T4&5)*** por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, rezulton se stafi akademik i programit të studimit angazhohet vazhdimisht në punë kërkimore shkencore të cilat përvec anëve të tjera positive sjellin edhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Në fund të cdo viti akademik secili nga pedagogët plotëson fomrualin e arritjeve akademike dhe kërkimorë shkencorë i cili i vihet në dispozicion Fakultetit ***(formulari i performancës), (raportet vjetore), (faqja zyrtare e universitetit).*** <br> Profesorët në përbërje të stafit të angazhuar janë personalitete të fushës së stomatologjisë dhe njëkohësisht me eksperiencë jashtë vendit ***(T6).*** Sipas deklarimeve, një pjesë e mirë e tyre kanë qënë të angazhuar në pozicione të larta në fushën e shëndetësisë apo ekspertë të ndryshëm. Kjo bën që ata të jenë zbatues të metodave të reja invovative në funksion të përmirësimit të cilësisë. <br> GVJ e konsideron pikë të fortë cilësinë e personelit akademik dhe profilin e lartë akademik që ata kanë. ***(cv e stafit)*** |
| **Kriteri 8.** Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor | Bazuar në dokumentin ***"Lista e pedagogëve të ftuar 18-19"*** rezulton së FMD fton letorë vendas dhe të huaj të cilët kontrinojnë në përmirësimin e programit të studimit me përvojën e tyre. Një praktikë tjetër e ndjekur nga FMD janë edhe aktivitetet e realizuara me lektorë të huaj si pjesë e bashkëpunimeve që UMT/FMD ka patur ku ndër kryesorët përmendim: (lista e aktiviteteve) <br> Referuar ***RVB, faqe 44***, disa prej tyre janë: lektor Prof. C. D, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | M. L.S, 24.4.2018, , Dr. R. Th, 1 Nentor 2017, Dr. A. V<br>Nxitja e këtyre bashkëpunimeve dhe partneriteteve (***marrëveshjet dhe bashkëpunimet***) ka ndikuar cilësisht performancën e stafit por edhe ngritjen në një nivel më të lartë të transmetimit të dijeve tek studentët.<br>Përfshirja e stafit në mobilitete në vizita shkëmbimi në kuadër të projekteve në Universitetin e Barit, Universiteti Gabriele d Annuzio Chietti, Pescara, Itali Charite Berlin etj. (lista e aktiviteteve) | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Në rregulloren e porgramit të studimit janë të përcaktuara qartë objektivat dhe aftësitë që studentët do të përfitojnë në përfundim të këtij cikli studimesh ***(rregullorja e programit).***<br>Studentët pohuan se njoihen rregullisht me përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve ***(T4&5).*** Ato i bëhen të ditura studentëve në fillim të vitit akademik. Vlerësimi i studentit realizohet gjatë gjithë vitit duke e vlerësuar atë për angazhimin e tij gjatë zhvillimit të veprimtarive formuese si dhe në rezultatin e marrë në provimin final të lëndës/modulit. Format e testimit të njohurive janë për aktivizime në seminare, praktika, dorëzim projektesh, detyrash, testime të pjesshme dhe provimi final |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Referuar takimit që GVJ realizoi me stafin akademik ***(T6)*** rezulton se në orën e parë të fillimit të vitit akademik, pedagogët i njohin studentët me syllabusin e lëndës , ku janë të përcaktuara qartë format e vlërësimit të njohurive dhe metodologjitë e mësimdhënies. ***(syllabuset).***<br>Në fillim të çdo lënë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit, e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.<br>Detaje janë paraqitur edhe në manualin e studentëve ***(manuali)*** i cili përditësohet çdo fillim viti dhe u vihet në dispozicion studentëve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | Në syllabuset e lëndëve jepen informacione se studentët gjatë vitit akdemik vlerësohen me anë të projekteve, detyrave të kursit, punëve laboratorike, anagzhimit në seminare, praktikës profesionale, provimeve, provimit të diplomimit apo temës së diplomës ***(syllabuset).*** Kjo u konfirmua edhe nga dy takimet me studentët ***(T4&5)***<br>Provimi përfundimtar në varësi të lëndës, mund të jetë me gojë oseme shkrim, përgjegjësi departamentit në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të departamentit përcakton tezat e provimit në të cilat përmbajnë tre deri në katër pyetje.<br>Studenti merr kohën e tij per tu përgatitur dhe përgjigjet para komisionit ***(programi, syllabuset,T6)*** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Instit<u>ucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</u>** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Bazuar në rregulloren e programit, vlerësimi i studentëve për cdo lëndë realizohet përgjatë vitit akademik dhe në provimin përfundimtar. ***(rregullore programi)***<br>Rëndësi të veçantë ka angazhimi i studentëve në seminare apo në realizimin e projekteve të cilat reflektohen në vlerësimin final. ***(syllabuset e lëndëve)***<br>Në takimin me studentë evidentuan nota e ponderuar për lëndët me disa module ***(T4)*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Në RVB ***(faqe 46-47),*** është dhënë informacion i detajuar në lidhje me platformat që përdor universiteti dhe fakulteti.<br>Një ndër to është sistemi ESSE3 ***(rregullore dhe manuale sistemi)*** por ndërkohë është duke implementuar edhe platforma të edukimit në distancë ***(e-learning)*** të cilat do të përdoren për teste filtruese ***(T6)***<br>Në program studimi për vetë karakterisitikën e tij për profesionale në shumicën e lëndëve nuk aplikon testimin më anë të sistemeve elektronike por këto forma zbatohen për përzgjedhjen e studentëve specializantë.<br>Këtë proces përzgjedhës fakulteti e realizon në bashkëpunim me Qëndrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) ***(testimi i specializantëve)*** |

| | |
|---|---|
| | GVJ vlerëson pozitivisht angazhimin e institucionit për promovimin dhe përdorimin e metodave elektronike në testimin e rezultateve të të nxënit. Kjo në vetvete rrit transparencën në vlerësimin e studentëve |
| **Kriteri 3.** Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.<br>**Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie. | Bazuar në RVB dhe ***"Regulloren e provimeve"*** rezulton se Komisionet e provimeve përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv.Dekanin për mësimin dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Provimet realizohen me sekretim kur ato zhvillohen me shkrim ***(rregullore e provimeve)***. Mjediset ku zhvillohen provimet janë të monitoruara me personel që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit të provimeve ***(programi dhe rregullore provimi)***<br>Komisioni i provimeve siguron transparencë maksimale, nuk lejon abuzimin nga studentët, kopjimin apo forma të tjera që defomojnë vlerësimin që çdo student meriton.<br>Rezultatet paraprake të provimeve/testimeve jepen nëpërmjet sistemit në mënyrë të personalizuar ***(rregullore dhe manuale ESSE3).*** |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Bazuar në takimin që GVJ realizoi me studentët, stafin akademik dhe sekretarinë mësimore ***(T4&5, T6, T8),*** rezulton se stafi akademik i njeh studentët me vleresimet e tyre me anë të një séance diskutimesh që rezlizohet përpara se notat e studentëve të hidhen në sistem.<br>Komisioni i provimeve siguron transparencë, nuk lejon abuzimin nga studentët, kopjimin apo forma të tjera që defomojnë vlerësimin që çdo student meriton. Rezultatet paraprake të provimeve/testimeve jepen nëpërmjet sistemit<br>Në varësi të profilit të lëndës/modulit, testimi mund të jetë edhe me vlerësim të studentit bazuar mbi produktin / detyrëne lënë na praktikën e zhvilluar.<br>Gjatë testimit të njohurive të studentëve gjatë vitit, instrukton, këshillon dhe orienton studentët në fillim të semestrit, në rastin kur ata kanë pjesë të modulit edhe detyra kursi apo projekte kursi se si duhet të strukturohet një punë e tillë. |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në UMT funksionon Këshilli i Etikës i cili ka dhe rregulloren dhe e vet ***(rregullore KE).*** Në takimet e realizuara, GVJ u informua FMD dhe më konkretisht komisioni i provimeve angazhohen të mos tolerojnë |

| | |
|---|---|
| | forma të kopjimit apo plagjiaturës në punimin e diplomës apo punimeve në detyrat e kursit dhe projektet. ***(T6)*** |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rreferuar Rregullores së Porgramit të Studimit dhe Rregullorës së Fakuletit rezulton se pasi studentët njihen me vlerësimin e marrë në provime me anë të sistemit, ata kanë dy ditë kohë për të ankimuar apo shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me vlerësimin. |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Komisioni është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Nëse studenti nuk është i kënaqur me sqarimin e komisionit, ka të drejtë kërkoj rishikim të testit nga një komision tjetër i cili ngrihet me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit pasi analizon pretendimet. |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | Në rastë të tilla komisioni ballafaqon tezën e studentit me tëzen e pergjigjeve, nësë edhe pas kësaj procedurë studentëi përsëi shpreh pakënaqësi lidhur me vlerësimin, ai ka të drejtë të kërkojë vlerësimin e testit nga një komision tjetër. E gjithë procedura e ndjekur për ankimin e vlerësimit nga studentët më anë të procesverbaleve përkatëse, arkivohet pranë arkivës së FMD.<br>Studentët kanë referuar raste ku kanë patur ankesa dhe janë drejtuar në departament ose në dekanat personalisht ose nëpërmjet këshillit studentor ***(T4&5). (programi).*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.7**<br>**Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Referuar Rregullores së programit të studimit, në nenin 6 të saj ka të specifikuar misionin e programit të studimit i cili është të pajisë studentët me njohuri të thelluara profesionale mbi shëndetin dentar, parandalimin dhe kurrimin e patologjive qe prekin shëndetin dentar për fëmijë dhe të rritur. ***(programi i studimit)***<br>Shpërndarja e ngarkesës mësimore në lëndë të formimit të përgjitshëm dhe profesonal, u mundëson studentëve rritje |

| | |
|---|---|
| | profesionale në mënyrë progresive. ***(plani mësimor)*** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe syllabuseve rezulton se programi i studimit i mundëson studentëve pajisjen me dije në fushën e teknologjisë së informacionit vecanërisht në lëndën, Informatikë e Aplikuar për Shkencat Mjekësore, me dije mbi fushën humane e sociale në lëndët, Psikologji dhe Kulturë Gjuhe si dhe me njohuri mbi gjuhën e huaj në lëndën, Gjuhë e Huaj. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. | Studentët në përfundim të cdo semsetri testohen mbi njohuritë e përfituara në cdo lëndë. Syllabuset e lëndëve me objektivat e tyrë përkatës rishikohen cdo fillim viti akademik, kjo bën që ato të jënë të përditësuara me të rejat e fundit mbi shkëncën e shëndëtit dentar. ***(Syllabuset; Takimi me stafin akademik; Takimi me studentët)*** |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Referuar RVB, në përfundim të semestrin në javën e fundit të tij pedagogu përkatës orienton studentët mbi strukturën dhë natyrën e pyetjeve që do të pqrmbajë provimi final dhe për pëshën e tyrë në vlerësim. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Referuar evidencës ***"Pedagoget e huaj të ftuar" dhe "Pedagogët e jashtëm dhe të ftuar"***, rezulton se përsoneli akademik i programit të integruar studimit Msc Stomatologji, realizon herë pas herë gjatë vitit akademik orë dhe seminare të hapura mbi të rejat e fundit të teknologjisë dhe shkencës. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Bazuar në infrastrukturën që ka fakulteti dhe universiteti ***(infrastruktura)***, listës së marrëveshjeve që FMD disponon për realizimin e praktikave të studentëve ***(lista e marrëveshjeve)***, rezulton se FMD dhe të gjitha strukturat spitalore më të cilat bashkëpunon dhe bashkërendon punën e vet, ofrojnë ndaj studentëve të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e praktikave, veçanërisht trajnimet dhe praktikimi me pacientë që trajtohen në këto klinika apo qëndra.<br><br>Studentë rezulton të jenë të kënaqur në lidhje me realizimin e mësimdhënies, pasi sipas tyre ata marrin informacionin e duhur teorik dhe prgatiten mjaftueshëm për realizimin e praktikave ***(T4&5).*** Nga ana tjetër ata vlerësojnë maksimalisht realizimin e praktikave profesionale dhe mundësitë që u jepen për të punuar me pacintë. Në disa raste ata angazhohen edh egjatë pushimeve verore për të praktikuar njohuritë e tyre. |

| | |
|---|---|
| | GVJ e konsideron mjaft pozitive qasjen e fakultetit realzimin e procesit mësimor dhe të praktikave profesionale si dhe në krijimin e mundësive për studentët. |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | GVJ konstaton se stafi nxit studentët për punën në grup me anë të detyrave të kursit, prezantimeve qe studentët realizojnë në konferenca të ndryshme me focus kërkimor shkencor apo edhe me anë të projekteve të krusit.***(T6)*** |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Raportet midis formave të mësimdhënies janë organizuar në mënyrë të tillë që të garantojnë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë e thelluara profesionale të studentëve si dhe t`i pajisin ata për ciklin e tretë të studimeve. ***(programi i studimit)***<br>Programi është bazuar në nevojat që ka ky profesion dhe në ecurinë e zhvillimit të stomatologjisë dhe teknologjisë që aplikohet në të ***(plani mësimor)***<br>Për të zhvilluar më tëj aftësitë e përdorimit të teknologjisë programi ka në përmbajtje module të formimit të përgjithshëm, teknologjisë dhe zbatimit të saj në mjekësi, etikës profesionale dhe komunikimit, administrimit të pacientit etj.<br>Studentët në përgjithësi u shprehën të kënaqur me klimën e krijuar në fakultet për zhvillimin e mësimdhënies, ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet ***(T4).*** Përfshirja e tyre rezulton të jetë e gjithanshme dhe e evidentueshme.<br>Në RVB faqe 50 – 51, është analizuar përfshirja e studentëve në veprimtari të ndryshme të realizuar nga fakulteti. |
| **Kriteri 9.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Ka një numër të madh aktivitetesh të organizuara nga fakulteti, organizata studentore apo institucione të tjera ***(manuali i studentëve, aktivitete me studentë, T4).***<br>Studentët shprehen të kënaqur dhe të motivuar për të marrë pjesë në programë mobiliteti ku disa prej tyre janë mbeshtetur edhe me bursa 3 mujore. ***(mobiliteti studentëve).*** |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | Fakulteti ka mbështetur disa bashkëpunime me organizata të tjera studentore si Brainstorm duke vënë në dispozicion infrastrutkurën didaktike dhe laboratorike ***(veprimtari me studentë).***<br>Grupi i jashtëm e vlerëson angazhimin e institucionit për përfshirjen e studentëve në veprimtari të tjera jashtë procesit mësimor në kuadër të mobilitetit, siç janë seminare, konferenca workshopë etj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi III.8<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Referuar statutit të UMT, rezulton e percaktuar qartë procedura që studentët duhet të ndjekin për diplomin si me provim final apo me temë diplome ***(statuti).***<br>Në Rregulloren e Fakultetit tregohet qartë procesi i diplomimit të studentëve që studiojnë në FMD.<br>Në programin MSc. Stomatologji, janë parashikuar dy forma diplomimi:<br>- me provim me shkrim nëse studenti ka shlyer të gjitha detyrimet;<br>- me temë diplomë nëse mesatarja e studimeve është mbi 8 dhe studenti përzgjedh këtë formë të mbrojtjes së diplomës<br>Në secilin rast, studenti ka informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe realizimin e tij.<br>Në takimet me personelin dhe drejtuesit u diskutua gjerësisht se pse institucioni ka zgjedhur këtë formë diplomimi por nga argumentimet u theksua se procesi i mbrojtjes së diplomës është mjaft i rëndësishëm dhe kompleks dhe se punimet e paraqitura duhet të plotësojnë kriteret shkencore. ***(rregullore)***<br>Nga eksperienca e deritanishme rezulton se për studentët me rezultate jo të mira kjo nuk është e mundur dhe për këtë arsye studentët me mesatare nën 8 i nënshtrohen provimit final. ***(T1, T2)*** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Në rregulloren e FMD dhe në rregulloren e programit të studimit studentëve që i nënshtrohen provimit final i vihen në dispozicion informacionet e nevojshme, fakulteti dhe departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të testimit dhe vlerësimit. Në shërbim të studentëve vihen në dipozicion informacione, udhëzime, materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Sipas rregullores së programit të studimit dhe rregullores së provimeve, studentët gjatë provimit final, testohen për të gjitha njohuritë që kanë fituar që nga viti i parë e deri në vitin e 5, duke përfshirë kështu të gjitha lëndët që ata kanë zhvilluar përgjatë studimeve të tyrë.<br>Vlerësimi në provime varet nga lënda dhe nga syllabusi i miratuar. Fakulteti respekton lirinë akademike në përcaktimin e kritereve të vlerësimit për lëndët. |

<table>
<tr><td>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</td><td>Referuar evidencës “Listë Studentësh për diplomën” të paraqitur në DVV, rezulton se cdo pedagog i stafit akademik ka të drejtë të marrë në udhëheqje për punimin e diplomës 2 studentë, udhëheqëi i orienton studentët në përcaktimin e temës se diplomës dhe i asiston ata gjatë punimit të tyre.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</td><td>UMT ka specifikën e bashkëpunimit me Qëndrat spitalore universitare në vend (VKM Qendrat Spitalore), (Klinika Stomatologjike Univeristare; Infrastruktura; Marrëveshjet e Bashkëpunimit). Infrastruktura e vënë në dispozicion të studentëve i ndihmon ata për realizimin e testeve apo punëvë të tyrë laboratorike përgjatë ciklit të studimeve.<br>GVJ identifikon mjaft të rëndësishme mundësitë që u krijohen studentëve për të kryer matjet, analizat, teste në mjedise spitalore, në kuadër të realizimit të punimeve të tyre studimore, shkencore.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</td><td rowspan="4">Bazuar në RVB (faqe 53- 54), “Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dh enxjerrjen e konkluzioneve. Nesë ato janë në përputhje rezultatet e pritshme, udhëheqësi jep udhëzimet e nevojshme dhe orienton studentit për zhvillimin e mëtejshëm të diplomës.”.<br>Sic rezultoi dhe nga takimi që GVJ rezlizoi me studentët, ata vlerësohen me notë mbi njohuritë për provimin final apo punimin e diplomës të cilat paraqiten në një provesverbal. (shembull proces verbal provimi)<br>Në evidencën “Formati i Diplomës dhe Suplementi”, por edhe nga informacioni që GVJ mori gjatë takimit me studentët (T4&5), rezulton se në përfundim të ciklit 5 vjecar të studimit , UMT i pajis studentët me diplomën dhe suplementin e saj të cilat janë të miratuara nga MASR.<br>Studentët përvec diplomës dhe suplementi pajisen dhe me një kopje të programit të studimit ku paraqitet e gjithë ecuria e tyre mësimore gjatë ciklit të studimit.<br>Formati dhe suplementi janë të miratuara nga Ministria e Arsimit (formatet)</td></tr>
<tr><td>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë</td></tr>
<tr><td>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen</td><td>GVJ konstatoi se institucioni ruan dokumentacionin në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Në RVB faqe 54 dhe në rregulloren e arkivës së UMT institucioni shprehet se “regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe</td></tr>
</table>

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *çertifikatave që vërteton emetimin e çertifikatave dhe diplomave, dokumentet si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen, pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më paas dorëzohen në Arkivën Shtetit Shqiptar.* <br> Të dhënat origjinale të studentit atij në përfundim të studimeve, i kthehen ndërsa institucioni ruan kopje e njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike" | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1** <br> **Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Në organikën e UMT (***organigrama***), listën e stafit akademik në fakultet (***statistika***), listën e personelti akademik për programin e studimit 19-20 (***personeli akademik i programit***), janë paraqitur të dhëna për stafin akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. <br> Meqënëse programi ofrohet në nivel fakulteti, ai koordinohet nga dekani i FMD si dhe nga koordinatori i programit (***zv.dekani***). Programi i studimit zë peshën kryesore në programet që ofron FMD pasi vetëm dy vite më parë fakulteti ka licensuar dy programe Bachelor ***(lista e programeve).*** <br> Fakulteti ruan të dhëna për stafin e angazhuar në programet që oforn FMD. Të dhënat përditësohen çdo vit akademik të dhe përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. Këto lista sic rezultoi dhe nga takimi me zyrën e burrimeve njërëzore |

| | |
|---|---|
| | përditësohen para fillimit të cdo viti akademik apo semestri dhe në mënyrë të vazhdueshme në varësi të aktiviteti që ka stafi ***(vizita në zyrën e burimeve njerëzore)*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Nga takimi që GVJ rezlizoi me administratën e universiteti dhe fakultetit, nga vizita në zyrën e burrimeve njerëzore dhe nga shqyrtimi i evidencës *"Punësimi i personelit akademik efektiv";"Punësimi i stafit akademik PAK",* se procedurat zhvillohen në përputhje me kriteret ligjore në fuqi për rekrutimin e personelti akademik. Procesi zhvillohet çdo vit akademik i koordinuar nga fakulteti dhe rektorati i universitetit.***(T9)*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Kriteret dhe procedurat e posacme për rekrutimin e personelit ***(procedurë rekrutimi)*** përcaktohen nga departamentet dhe fakulteti në bazë të nevojave që ai ka për punësimin e stafit akademik të cilat më pas i përcillën zyrës së burrimeve njërëzore e cila bën shpalljen e tyre në faqen e internetit dhe në Agjencinë e prokurimeve publike. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit | Informacioni i dhënë në takimin me administratën ***(T9)*** dhe në RVB ***(faqe 56),*** është i plotë dhe evidentohet që institucioni i ndjek procedurat standarte të rekrutimit.<br>Fakulteti dhe universiteti ngre komisione të poscme për vlerësimin dosjeve te aplikanteve, në këto komisione marrin pjesë staf akademik i departamenteve të FMD, përaqesues nga dekanati, nga zyra e burrimeve njërëzore dhe nga Rektorati.<br>*"Renditja përfundimtare e aplikantëve bazohet në sistemin e pikëzimit të miratuar nga Senati akademik , në të cilën përllogariten pikët nga konkurimi me dosje dhe intervista e drejtëprdrejte me aplikantët"*<br>Procedura ndiqet për personelin e brendshëm dhe të jashtëm. Për personelin e jashtëm, lista përfundimtare miratohet nga Senati (***lista e personelit të jashtëm***).<br>Sipas deklarimeve të përfaqësuesëve të fakultetit, në rinovimin e kontratës, merren parasysh vlerësimet gjatë vitit nga departamentet dhe vlerësimi nga studentët. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| |
|---|
| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon** |

| **programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Rregullorja e UMT përcakton se insitucioni angazhohet në krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm pune për stafin akademik.<br>Personeli shprehet ***(T6)*** se për realizimin e programit të studimit është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme në fakultet si dhe infrastruktura universitare shëndetësore dhe laboratorike dhe duke i dhënë kështu mundësinë e barabartë përsonelit akademik në kryerjën e detyrëve dhe funsksioneve të tyre.***(infrastruktura e fakultetit dhe universitetit)*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Në organikën e UMT ka njësi që kanë si qëllim formimin e vazhduar si p.sh Qëndra e zhvillimi profesional ***(organigrama).*** Referuar evidencave të paraqitura, gjatë vitit akademik mundësohet ofrimi i leksioneve të hapura me lektorë të huaj, mobiliteti në kuadër të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ***(T7).*** Trajnimi nga shërbimet spitalore në kuadër të përmirësimit të metodave të mësimdhëniës, trajnimet e realizuara në bashkëpunim me AKKSH etj, dëshmojnë se UMT është i angazhuar në përmirësimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik ***(RVb faqe 58)*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve | Bazuar në organigramën e FMD, rezulton se fakulteti është një strukturë e vogël dhe lehtësisht i menaxhueshëm.<br>Zyra e burimeve njerëzore ***(procedura e zyrës)*** disponon listën e personelit akademik të programit të studimit dhe atij mbështetes dhe rezulton se fakulteti disponon burimet e nevojshme njerezore për realizimin me sukses të programit të studimit. GVJ mendon se rritja e numrit të programeve ose i studentëve deri në 15 % duhet të shoqërohet me rekrutime të reja të stafit akademik dhe administrativ.<br>Zhvillimi i profilit didaktik të stafit të fakultetit kryhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet ofrimit të leksioneve të hapura me lektorë të huaj, ofrimin e trajnimeve lidhur me metodat inovative në specialitet përkatëse, programet e mobilitetit në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, pjesmarrje në aktivitete shkencore të përbashkëta, trajnime kualifikuese etj. Fakulteti për përdorimin me lehtësi të platformave të ndryshme ka kryer trajnime dhe vënë në dispozicion manuale |

Adresa: "Rruga e Durrësit",
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | dhe rregullore të ndryshme për personelin akademik. ***(manuale sistemi)*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Bazuar në RVB ***(faqe 59-60)*** janë paraqitur informacione të detajuar mbi kapacitet që ka fakulteti dhe universiteti. Edhe në në evidencën e Infrastrukturës së UMT dhe FMD rezulton se mjediset në dispozicion të programit, të ofruara nga fakulteti janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvatje të procesit mësimor ***(infrastruktura).***<br>Grupi i vlerësimit vlerëson infrastrukturën spitalore që disponon UMT dhe FMD mjaft të rëndësishme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike për këtë program studimi.<br>Studentët e Programit të studimit, realizojnë mësimin në përgjithësi paradite në orar të përshtatshëm që u krijon mundësi studentëve për të shfrytëzuar maksimalisht kohën për të studjuar apo punuar në bibliotekë. Ky orar është mjaft i përshtatshëm veçanërisht për studentët që realizojnë praktikat me pacientë realë. Sipërfaqja në dispozicion të procesit mësimor në godinën e Fakultetit është rreth 1200 $m^2$ e cila në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, natyrën specifike të lëndëve përkatëse shfrytëzohet në kapacitet të plotë. Fakulteti përdor gjithashtu sallat dhe mjediset e tjera që disponon UMT.<br>Sikundër u theksua në takimin me dekanin dhe administratorin e fakultetit ***(T1, T7),*** është parashikuar rritja e numrit të auditorëve brenda fakultetit nëpërmjet një shtese në godinën aktuale e cila mbetet një sfidë për FMD në të ardhmen. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete | Fakulteti ve në dispozicion infrastrukturë të mjaftueshme për proceset akadmeike si: godina e UMT, godina e lëndëve |

| | |
|---|---|
| elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | paraklinike, godina e farmacise dhe shëndetit publik, godinat e Shkencave Mjekësore Teknike, salla në QSUT dhe spitalet e tjera,<br>mjediset e Fakultetit të Shkencave të Natyrës etj.(infrastruktura) (marrveshjet)<br>Mjediset në dispozicion të programit, të ofruara nga |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | universiteti dhe fakulteti janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvatje të procesit mësimor (infrastruktura). Nga vizita që GVJ realizoi në ambjentët e FMD rezulton se insitucioni disponon ambjente me ndricim natyral dhe të pajisora me projektorë, kopjutera, gjithashtu.<br>GVJ për shkak të kohës së limituar nuk vizitoi ambientet jashtë godinës qëndrore të FMD por është informuar nga koordinatori i universitetit për godinat dhe sallat që ndodhen në brendësi të UMT.<br>Fakulteti disponon 2 laboratorë për realizimin e praktikave lëndore.<br>Këto laboratorë janë të pajisur mirë me mjetet e domosdoshme për studentët për realizimin me skukses së punëvë laboratorike, gjithashtu sallat e leksiove dhe seminareve janë të përshtatura për realizimin teorik dhe praktik të mësimdhënies ***(manuali i studentit), (infrastruktura).*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Bazuar në RVB rezulton se UMT ve në dispozicion të studentëve të programit të studimit, laboratorin informatik i cili gjendet në godinen e Fakulteti të Shkencave Mjekësore Teknike, gjithashtu studentët e programit të studimit mund të përdorin kompjuterat që ndodhen në ambjentet e bibliotekës së insitucionit. (infrastruktura e bibliotekës, ***(T7)***<br>Sic rezultoi edhe nga vizita në ambjentet e FMD, ka mbulim me rrjet ëi-fi në dispozicion të studentëve ***(manuali i studentëve) (infrastruktura dhe vizita e ambienteve)*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të | FMD përvec ambjenteve që disponon si, infrastruktura mjekësore e QSUT, Klinika Stomatologjike Universitare dhe laboratorët e prakikave, disponon gjithashtu marrëveshje me palë të tjera në kuadër të realzimit të programit të studimit.<br>Lista e marrveshjeve dhe bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera ***(T10),*** sigurojnë mjedise të mjaftueshme, të për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| tjera praktike | Në marrveshjet e bashkëpunimit është theksuar përdorimi i ndërsjelltë i kapaciteteve infrastrukturore midis institucioneve nënshkruese ***(marrëveshja Universiteti Aldent dhe Iodent)*** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ identifikoi se UMT ka disa biblioteka. Edhe FMD ka një të tillë në të cilën dhe u realizuan takimet e GVJ. Biblioteka kryen dixhitalizimin e skedarëve, si dhe shkëmben informacion me biblioteka të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit. Fondi i bibliotekës mbulon kryesisht fushat e shkencave mjekësore, të shendetit publik, stomatologjike, farmaceutike dhe të shkencave teknike mjekësore, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Gjithashtu, kjo bibliotekë ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës. ***(informacion për bibliotekën), (manuali i studentëve), (T4&5)***<br><br>Të njëjtën mënyrë funksionimi ndjekin edhe bibliotekat e fakulteteve të cilat janë nën varësinë e bibliotekës qëndrore të UMT.<br><br>Referuar të dhënave të vëna në dispozicion, rezulton se studentët kanë mundësi të gjëjne në bibloteken e FMD dhe UMT literaturën që pedagogët kanë përcaktuar në syllabsin e lëndëve. Bibloteka e UMT disponon rreth 53000 libra dhe reth 18000 koleksione revistash shkencore ***(RVb- faqe 61)*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Universiteti ka vënë në dispozicion libraritë on line me akses për personelin akademik dhe studentët në të cilat mund të aksesohen botimet elektronike të disa librarive on linë ***(RVB faqe 62).***<br>UMT përdor sistemin e rrejtit akademik dhe nëpërmjet tij, stafi dhe studentët aksesojnë, bibliotekën on line U-library.<br>Në marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur, personeli mund të shfrytëzojë edhe biblotekat dhe infrastrukturën që partnerët dispoznojnë (***marrveshjet***). |

| | |
|---|---|
| | Të gjitha këto vihen në dispozicion të studentëve pa pagesa shtesë. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Në bibliotekën e fakultetit janë vënë në dispozicion të studentëve të programi të studimit 32 poste leximi, si dhe janë pajisur me kompjutera dhe projektore të gjitha sallat, të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët gjatë e ciklit të tyrë të studimit.<br>Bazuar në takimin me studentët ***(T4&5)***, në përgjithësi literatura e lëndëve është në shqip dhe ofrohet nga pedagogu i lëndës. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Bibliotekat e institucionit, përveç botimeve të reja që shtohen vazhdimisht, pasurohen me disertacionet, botimet shkencore dhe tekstet mësimore të personelit akademik të institucionit. Për shkak të specifikës që ka mjekësia, drejtuesit deklaruan që fokusi kryesor është sigurimi i literaturës elektronike të fundit dhe më pas ato përshtaten nga pedagogët e lëndëve. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Në RVB dhe takimin që GVJ ***(T3)*** realizoi me studentët u deklarua se *"në periudha të veçanta të vitit akademik, biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare të zgjatura. Këshilli studentor shfrytëzon në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor ku nëse aksesohet jashtë orareve zyrtare të funksionimit të saj, caktohet një student përgjegjës i cili menaxhon funksionimin e biblotekës gjatë këtij orari."*<br>Fakulteti ka vënë në dispozicion të biblotekës një person i cili administron bibliotekën dhe është në dispozicion të kërkesave të studentëve ***(Takimi me administratën)*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UMT përdor sistemit të bazës së të dhënave ESSE3 të menaxhuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar ***(rregullore dhe manuli i përdorimit).***<br>Nëpërmjet ESSE3, ofrohen funksionalitete të nevojshme për sekretarinë mësimore, kërkimin shkencor ku çdo pedagog publikon listën e punimeve shkencore, menaxhimin financiar, |

| | |
|---|---|
| | etj, të cilat janë duke u zbatuar.<br><br>Nga vizita që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore, takimet me studentët dhe personelin akademik u informua mbi përdorimin e sistemin ESSE3.<br>Ky sistem është duke u zbatuar hap pas hapi pasi studentët e viteve të fundit menaxhohen ende me procesverbale të printuara ***(procesverbal provimi)***<br>Sikundër u theksua nga studentët, ata informohen mbi notat e provimeve, orarin e mësimit, aplikimi online i maturantëve, matrikulimi i studentëve etj.<br><br>Nëpërmjet këtij sistemi, institucioni realizon procesin e aplikimit online të kandidatëve, menaxhon dhe monitoron procesin e provimit të shtetit ose licencimit, si dhe procesin e konkurimit nëpërmjet testimit të kandidatëve për programet e specializimeve afatgjata ***(manuali i sistemit)*** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Bazuar në RVB ***(faqe 63)***, rezulton se me anë të sistemit ESSE3 çdo pedagog mund të përditësojë listën e punimeve shkencore. Stafi administrativ, zyra e financës dhe sekretaria gjithashtu kanë akses në këtë sistem. Secili nga zërat e përmendur logohet në sistem me anë të kredencialeve personale, si studentët ashtu edhe stafi akademik e administrative. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Në UMT, sipas deklarimeve të NJSBC, do të ofrohen dhe shërbime të tjera si provimi i licencimit, testimi i kandidatëve për programet e e studimit. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Ndërkohë marrëveshja me RASH parashikon zhvillimin e mëtejshëm të moduleve të reja ***(marrveshja RASH-UMT)***<br><br>Sipas deklarimeve të stafit dhe studentëve (T4& T5, T6) përdorimi i ESSE3, dhe shërbimet që ofrohen, shkrutojnë procedurat, rrisin transparencën dhe sigurinë e të dhënave. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Paralelisht, u deklarua që UMT është duke ndërtuar qëndrën e simulimit klinik e cila parashikon aplikimin e sistemeve të reja jo vetëm për menaxhimin e procesit mësimor por edhe për simulime në mjekësi ***(takimi me administratën, qëndra e simulimi klinik)***<br>Bazuar edhe në vlerësimin e stafit dhe studentëve, GVJ e vlerëson të përshtatshme përdorimin e sistemeve të |

| | |
|---|---|
| | menaxhimit në FMD. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | Fakulteti ka dy faqe interneti *(RVB – faqe 64)* dhe nga shfletimi i tyre rezulton se insitucioni nëpërmjet kësaj hapësire, pasqyron të gjithë aktivitetin e tij në gjuhen shqipe dhe atë angleze, duke nisur me informimin e studentëve dhe stafit për mundësi mobiliteti , pasqyrimin e aktiviteteve në kuadër të programit të studimit, pasqyrimin e marrëveshjeve të lidhura në kuadër të praktikave etj.<br><br>*Faqja e fakultetit përmban informacione të limituara në gjuhën angleze dhe pavarësisht se informacionet kryesore në gjuhën angleze publikohen në faqen zyrtare të universitetit, GVJ rekomandon të përditësohet dhe faqja e fakuktetit me informacionet e duhura **(faqet e internetit)*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Institucioni ka paraqitur evidenca lidhur me aktivitetin financiar. Bazuar në evidencat e paraqitura në DVV si, *"Raporti vjetor mesimor kerkimor dhe financiar UMT 2018-2019.pdf; Te dhena financiare dhe per infrastrukturen ne funksion te programit.pdf"*, UMT harton cdo vit raport mbi ecurinë financiare të programit si dhe paraqet në të planifikimin e kostove ***(raportet vjetore), (hartimi i buxhetit)*** |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion | Ky plan ka të detajuar në brendsi të tij të gjitha zërat e nevojshëm për realizimin e programit të studimit, duke filluar nga mjediset për realizimin e programit, materialet e nevojshme, si projektore, kompjutera, libra etj.<br>Raportet vjetore përmbajnë informacione financiare mbi të ardhurat të ndara në zëra të caktuar, UMT bën një parashikim të të ardhurat që siguron fakulteti apo të ardhura të tjera<br>Fakulteti ka administratorin e vet ndërsa aktiviteti financiar zhvillohet në bashkëpunim me Administratorin e Universitetit dhe Bordin e Administrimit.<br>Në RVB dhe në takimin me dekanin ***(T1)***, administratorin u |

| | |
|---|---|
| të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | evidentua si problematike kufizimet ligjore në aspektin e menaxhimit financiar duke mos lejuar fleksibilitet në përdorimin e të ardhurave. ***(T1), (T8)*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Nga shqyrimi i DVV dhe RVB, si dhe nga takimi me dekanin e fakultetit (T1) rezulton se UMT kryen raporte audituese në fund të cdo viti akademik, ku përfshihen pasqyra e programit të studimit, kostot dhe shpenzimet të ardhurat të përfituara nga zerat e përmendur më siper etj.<br>UMT është insitucion publik dhe një pjesë të financimit të tij e merr nga buxheti i shtetit. Përdorimi i fondeve bazohet në legjislacionin në fuqi, institucioni i nënshtrohet auditeve financiare, që realizohen nga institucionet e parashikuara me ligj për këtë qëllim.<br>Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë përbërëse të tyre, realizohen nga njësitë e auditit të brendshëm të MAS-it, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga MF. (takimi me administratën e umt) |
| **Kriteri 4**. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Bazuar në raportet e fundit financiare si *"Raporti Vjetor 15-16, "Raporti i Veprimatrive 16-17", "Raporti i Veprimatrive 17-18", "Raporti vjetor mesimor kerkimor dhe financiar UMT 2018-2019"* dhe RVB rezulton se UMT në mbyllje të çdo viti akademik realizon raporte vjetore financiare të ecurise së programit duke vënë në dukje të dhënat financiare, analiza, realizimi faktik dhe zërat e shpërndarjes së buxhetit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | UMT si insitucion publik të ardhurat kryesore i siguron nga buxheti i shtetit. Duke patur parasysh këtë fakt, raportet vjetore të përmendura mësipër por edhe kuotat dhe kërkesën e madhe të studentëve për të studiuar në këtë program studimi, rezulton se program paraqet qëndrushmëri financiare për vazhdueshmërin e tij.<br>Kostot për përballimin e bursave të studentëve rimbursohen nga buxheti i shtetit ***(raportet vjetore), (statistikat përmbledhëse)*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

Adresa: "Rruga e Durrësit",
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.<br>**Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e insitucionit, rezulton se UMT ka praktika të cilat përfshijnë ciklin e plotë 5 vjecar të studentëve nga pranimi i tyre e deri në diplomim.<br>Kriteret dhe procedurat e programit përcaktohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Kriter përcaktuese për studnetët që duan të studiojne në programin e studimit Msc Stomatologji përcaktohen çdo vit nga fakulteti dhe Senati Akademik (për vitet e kaluara mesatarja ka qënë kriter kryesor dhe jo me e ulët se 8.5. ***(Kriteret e Pranimit në Programin e Studimit).***<br>Ndërsa kriteret e tjera lidhen me përzgjedhjen e maturantëve me rezultate të larta në lëndët fizikë, biologji dhe kimi. |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Në rregulloren e sekretarisë mësimore dhe takimin që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore, rezulton se regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet e institucionit. Procedurat janë të miratuara e të bëra publike në faqen e UMT dhe atë të FMD. ***(faqet zyrtare)*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Publikimi i kritereve nga ana e institucionit bëhet një vit në avancë. Kjo për tu dhënë mundësi maturantëve të njihen paraprakisht. Refruar rregullores se programit të studimit, takimit me student dhe evidencës ***"Kriteret e pranimit të studentëve"***, rezulton se FMD përvec kritereve të përgjithshme të përckatura nga MASR për maturën shtetërore, përcakton kritere të vecanta për studnetët që duan të bëhen pjesë e këtij programi studimi.<br>Nga statistikat të vëna në dispozicion, rezulton se programi i studimit është një ndër programet më të kërkuara në vend dhe |

| | |
|---|---|
| | përzgjidhen maturantët me rezultatet më të larta. (***statistika per numrin e aplikanteve).*** Në tre vitet e fundit kanë për 100 vende kanë aplikuar përkatësisht 2780, 2770 dhe 3218 maturantë. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Studentët deklarojnë se informohen në fillim të çdo viti akadmeik. Në takimin me dekanin e fakultetit, dhe studentët ***(T4&5)*** rezulton se Fakulteti në bashkëpunim me Këshillin Studentor organizojnë aktivitete informuese për maturantët e shkollave jo vetëm të Tiranës por edhe të retheve te tjera, në këto aktivitete behet një prezantim i programit të studimit si dhe i ambjenteve të fakultetit, maturantët kanë mundësinë të kalojnë një ditë pranë studentëve të vitit të 5 kryesisht për tu njohur më nga afër me atë cka ofron FMD.<br>Informacion i plotë informues paraqitet edhe ne manualin e studentit |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.<br>**Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Si institucion publik dh enë mbështetje të politikave sociale për kategori të ndryshme maturantësh, UMT alokon kuota të veçanta dhe kritere përzgjedhëse specifike për këto kategori. ***(statuti).*** Nga takimi me studentët ***(T3 &4)*** GVJ u informua se FMD një pjesë të kutoave për programin e studimit i ve në dispozicion të studentëve nga trojet shqiptare dhe komuniteteve. Duke qënë se program i studimit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, nuk ka prurje studentësh nga vendë te tjera jo-shqip folëse.<br>Bazuar në deklarimet e dekanit të fakultetit dhe koordinatorit të programit, synohet hapja e programit për studentët e huaj duke përfshirë fillimisht disa module në gjuhën angleze ***(T1&2)*** |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë | Fakulteti ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me njërin prind invalid.<br>Fakulteti ka parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi.<br>Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100% . Në këtë program studimi, për vitin akademik 2018- 2019 kanë përfituar burse 18 studentë në nevojë, me vlerë 1,198,550 lekë ***(mbështetja ndaj studentëve)***.<br>Referuar evidencës "Lista e studentëve që përfitojnë Bursë 18-19", rezulton se UMT mbeshtët studentët me anë të bursave , ku në vitin18-19 kanë përfituar bursë për këtë program studimi 124 studentë. Kriteri kryesor për studentët që të mbeshtet me |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | bursë është mësatarja e cila duhet të jetë mbi 9.<br>Në janar të vitit 2019, Senati dhe Bordi i UMT ***(vendimi i senatit dhe bordit UMT)*** kanë marrë vendimin për mbështetjen e kërkesave të studentëve nga i cili kanë mjaft studentë duke ditur që shumica e studentëve në këtë program studimi janë me rezultaet të larta në mësime | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Studentët informohen në mënyrë periodike. Organizimi i studentëve në Këshillin studentor të fakultetit, senatorët në çdo kurs, mundëson informim të shpejtë të tyre ***(T4&5).*** Me anë të këshillit studentor, studentët informohen në lidhje me procësin e tyre mësimor dhe procedurat e caktuara. (***aktivitete KSFMD)***<br>Studentët me anë te sitemit ESSE3 kanë mundësi të ndjekin e ecurinë e tyre gjatë vitit akdemik. Për kalimin nga një vit në vitin tjeter studentët duhet të grumbullojnë 30 kredite ECTS. ***(rregullore programi)*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Në evidencën *"Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit ne programet e UMT."* si dhe nga bashkëbisedimi me studentët rezulton se UMT ka të përcaktura qartë procedurat dhe kriteret për studentët të cilët duan te transferojnë studimet e tyre në UMT apo pë rata studentë të cilët kanë qënë pjese e kualifikimeve të pjsëshme.<br>Në dokumentin "Manual i Studentëve, takimin që GVJ pati me stafin akademik dhe syllabuset, rezulton se në orën e parë të fillimit të semestrit studentët njihen me syllabusin e lëndës nga pedagogu përkatës i cili u shpjegon mënyrën e vlerësimit, aftësitë dhe njohuritë që ata do të përfitojnë në fund të lëndës si dhe frekuentimin e saj.<br>Në rregulloren e programit të studimit dhe evidencës "Rregullore për realizimin e diplomës, mbrojtjes, vlerësimit" , rezulton se studentët e programit të integruar të studimit Msc Stomatologji mund të diplomohen në dy mënyra, me anë të |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | provimit final dhe me anë të tezës së diplomës për studentë më mesatare mbi 8. Procedura që duhet të ndjekën studentët për diplomin me temë diplome është e detajuar ndërkohë informacioni i nevojshëm mundtë merret nga koordinatori i programit, udhëheqësi i diplomës (T4) | | | |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Studentët informohen mbi progamin e studimit edhe me anë të rrjeteve sociale të FMD, manualin e studentit si dhe me anë të faqës zyrtare të UMT. Gjithashtu bazuar në evidencën *"Aktivitete të Këshillit Studentor"* FMD mbështet këshillin studentor në organizimin e takimeve informuese për maturanët të cilët duan të bëhen pjesë ë programit të studimit.<br>Përfaqësues të fakultetit organizojnë takime me maturantë për promovimin e programeve të studimit që fakulteti orfon.(manuali i studentit) | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Programi i studimit, plani mësimor dhe rregullorja e tij u vihen në dispozicion studentëve të rinj në javën e parë në institucion. Referuar rregullores se programit të studimit dhe takimit me studentët informohen se programi i studimi ofrohet në 5 vite akademik ku studentët në përfundim të ciklit 5 vjecar duhe të grumbullojne 360 kredite ECTS.<br>Studentët në fillim të cdo viti akademik marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me kohezgjatjen e programit të studimit, mënyrën e vlerësimit të njohurive, planin mësimor, si dhe literaturën që do i duhe të shqyrtojnë për cdo lëndë e cila është e parashikuar në syllabus. (T4&5), (programi) (plani mësimor), (manuali i studentit) |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Në evidencën *"Dosja e Programit të Studimit"* , studentët kanë të parashikuar të gjithë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit, informacionin e pergjithshëm, planin mësimor e deri më në hollësi me përmbajtjen e lëndëve, syllabuseve. (syllabuset e lëndëve), personelin akadmeik |

| | |
|---|---|
| | përgjegjës (stafi akademik) |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.<br>**Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.<br>**Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.<br>**Kriteri 6.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve | Dokumentacioni i programit përmban informacion embi mundësitë e punësimit.<br>FMD në bazë të marrëveshjeve të lidhura me insitucionet kombëtare dhe ndërkombetare si dhe me klinikat private i krijon mundësinë studentëve që pas përfundimit të ciklit të studimit të punësohën në disa prej tyre. (marrveshjet)<br>Referuar takimit me studentët, rezulton se studentët janë të informuar mbi infrastrukturën e fakultetit dhe ambjentet ku do të realizohet procesi mësimor (T4&5).<br>Informacione merret përmes grupeve në rrjetet sociale, faqes së internetit<br>Sistemi i menaxhimit ESSE3 u mundeson studentëvë informimin mbi ecurine e programit të studimit, notat e provimeve, frekuentimin, komunikimin me pedagogët, si dhe me sekretarinë mësimore.<br>Ky system nga sa u informua GVJ nga takimi me studentët, mund të përdoret edhe jashtë ambjenteve të FMD, pasi çdo student është i pajisur me user-pass |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.4<br>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.<br>**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin | Në rregullorën e UMT institucioni deklaron se dokumenton dh earkivon të dhëna për studentët. Në evidencën *"Statistika te pergjithshme per ecurine e studenteve_hyrje dhe dalje", Te dhena transferime_troje"* si dhe në takimin që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore, rezulton së FMD disponon statisktika mbi numrin e studetëve dhe ecurinë e tyrë, insitucionet nga vijnë nësë janë të transferuar, mastaren në hyrje dhe në dalje të tyrë si dhe nurmin e studentëve të diplomuar. Në statistikat e vëna në dispozicion të GVJ, është kryer edhe analiza mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe ecuria e tyre gjatë studimeve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | UMT është pjesë e projektit GRADUA i cili në thelb ka të bëjë me krijimin e bazës së të dhënave të studentëve të diplomuar në hapësirën europiane. (projekti gradua) | | | |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Nga takimi që GVJ realizoi me sekrëtarinë mësimore evidentoi se sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbarevajtjen e të dhënave të ecurisë së studentëve në programin e studimit, me anë të regjitrave të notave dhe të frekuentimit, rregjistrit të gjeneraliteteve, dosjeve të studentëve, përgjatë 5 vitëve të ciklit të studimit. (rregullorja e sekretarisë), (vizita në mjediset e fakultetit).<br>Dosjet e studentëve ruhen në sekretarinë mësimore (shembull dosje studenti) | | | |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Referuar RVB dhe takimit me studentët GVJ u konfirmua se ata përdorin sistemin ESSE3 i cili i shërben ndër të tjera edhe për administrimin, menaxhimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit të studentëve.<br>Edhe studentët, shprehen të kënaqur me sistemin e menaxhimit (T4&5). | | | |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | Në evidencën *"Relacion statistikor i numrit te aplikanteve ne vite dhe te notave; Statistika mbi qendrueshmerine e studenteve krahasuar me gjimnazin; Statistika te pergjithshme per ecurine e studenteve, hyrje dhe dalje"*, rezulton se UMT bën analiza dhe raportë mbi ecurinë ëe studentëve si dhe i njeh ata me mundësitë e punësimit, sic rezultoi dhe nga takimet që GVJ realizoi ne institucion. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Bazuar në statutin dhe rregulloren e UMT rezulton se studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik, Këshillat studentore, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet had-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel |

| | |
|---|---|
| | institucional dhe programi. Pjesë e grupit të vlerësimit të këtij programi ka qënë gjithashtu një përfaqësues i studentëve (përbërja e GVB) |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Në takimi me studentët (T4&5) dhe shqyritmi DVV, evidencave *"Procesverbal takimi dekanat_KSUFMD; Miratim kerkese KSFMD; Kerkesa Keshillit Studentor*; Aktet per perfshirjen e studenteve ne organet kolegjiale te UMT", rezulton se studentët janë pjese aktive dhe e rëndësishme e organeve përfaqësuese dhe administrative të UMT. Sic u konfirmua dhe nga takimi me studentët ata gjejnë mbeshteje të vazhdueshmë nga stafi akademik dhe administrative për sa i përket ecurisë dhe ngarkesës mësimore që ata kanë. |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Në mënyrë periodike, KSFMD, në bashkëpunim me fakultetin dhe struktura të tjera të UMT, kryen aktivitete në vit, duke nisur nga Konferencat Kombëtare të stomatologjisë ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive duke punuar tema shkencore dhe eksperimentale nën udhëheqjen e profesorëve, pjesëmarrje në Shkollat Verore e Dimërore Mjekësore apo trajnimet me tematika të ndryshme brenda e jashtë vendit (aktivitete studentore).<br><br>Studentët japin mendime për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, si tarifat e studentëve, kurrikulat e programeve, projektet kërkimore shkencore, praktikat, sezonet e provimeve etj. Një rast konkret i reflektimit të mendimit të studentëve është mënyra e realizimit të praktikave profesionale me studentë (diskutime me studentë) |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Nisur nga fakti qe studentët janë pjese e NJSBC dhe përfshihen nga FMD edhe në grupet e punës për hartimin e raporteve të vlerësimit të jashtëm sic konkretisht kanë vepruar në harimin e RVB, konfirmon faktin se insitucioni i angazhon dhe i bën pjesë studentët në rishikimet dhe përmirësimet e programit të studimit. (T4) |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Bazuar në takimin me studentët dhe takimin me sekretarinë mësimore, dosjen e programit, regulloren e programit si dhe në evidencën *"Format pyetesore per studente_2019"* , rezulton se studentëve i jepet mundësia dhe i garantohet e drejta për të dhënë mendimi dhe vlerësimin e tyre mbi metodat e mësidhënies, kontrollin e dijeve, gjithashtu në rast |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | pakënaqësish ata kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin e marrë pranë njësive përgjegjëse të cilat më pas ngrenë një komision ad hoc për rivlerësimin e rezultatit të studentëve (raportet e vlerësimit). | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | Në takimin me stafin akademik rezulton se personeli angazhohet dhe merr pjesë në konferenca, ëorkshope dhe kongrese ku mund të përmëndim Kongresin Ballkanik të Shoqatës së Stomatologëve, Kongresin e 3-të të realizuar nga FMD me tematikë, Zhvillimet bashkekohore në stomatologji dhe shëndetin oral. (aktiviteti kërkimor), (raportet vjetore)<br>GVJ vlerëson impaktin e kërkimit shëkncor dhe kontributin që jep Fakulteti i Mjekësisë Dentare në zhvillimin e stomatologjisë në Shqipëri. |
| **Kriteri 2.** Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | FMD në funksion të programit të studimit ka lidhur një sërë marrëveshjesh ndër të cilat janë edhe ato me insitucione të tjera të arsimit të lartë sic është marrëveshja "University Center Charite Berlin", me Universitetin e Aldo Moro, Bari; me universitetin Chieti, Pescara si dhe me universitetin e Prishtinë "Hasan Prishtina", të gjitha këto marrëveshje i mundesojne FMD shkëmbimin e eksperiencës së stafit akademik dhe mundësinë e pjesëmarrjes në projekte të ndryshme. (Lista e Marrëveshjeve Ndërkombëtare).<br>Bazuar në numrin e madh të bashkëpunimeve, GVJ vlerëson si pozitivisht përpjekjet e institucionit për të bashkëpunuar me organizma dhe institucione bredna dhe jashtë vendit në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe mobilitetit. |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore. | Bazuar në takimet me studentet dhe në evidencat e paraqitura në DVV si, *"Aktivitete me Studente dhe Brainstorm1; Aktivitete me Studente dhe Brainstorm2; Prezantime studentesh ne konferenca"*; rezulton se studentët janë gjërësisht të mbeshtetur të nxitur dhe të motivuar nga stafi akademik për të publikuar apo referuar punët e tyre kërkimore |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve | |

| | |
|---|---|
| kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | apo shkencore.<br>Studentët janë motivuar të marrin pjesë me publikime në Konferencën Kombëtare të Shkencave Mjekësore, Kongresin e dytë të FMD.<br>Sa i përkët stafit akademik nga takimi me dekanin e FMD dhe personelin akademik , GVJ u informua se personeli akademik mbeshtet në infrastkrukturën didaktike të FMD për punimet e tyre kërkimore shkencore dhe më pas publikimin në revista me factor impakti. (raporti i kërkimit shkencor).<br>Konstatimi i përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor vlerësohet pozitivisht nga ana e GVJ. Ky fakt mbështetet edhe në takimin me studentë (T4). |
| **Kriteri 5.** Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. | Stafi akademik rezulton se inkurajon gjithashtu studentët e masterit shkencor të marrin pjesë në konferenca shkencore. Organizimi kalon përmes filtrave shkencor. (veprimtaritë kërkimore)<br><br>Procedura e pjesëmarrjes në këto konferenca ndjek disa hapa të përcaktuara nga Bordi i Konferencës. Studentët motivohen të përdorin metoda të cilat do tju jepnin mundësi atyre të jenë më afër realitetit dhe nismave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe të përdorimit të teknologjive të inovacionit. Stafi është i përfshirë në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat.<br><br>Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët të cilët kanë në udhëheqje duke vlerësuar performancën dhe progresin e tyre. Pedagogu udhëheqës gjithashtu orienton studentin për prezantimin para komisionit të mbrojtjes. dhe në varësi të cilësisë së punimit, ato publikohen në dy revistat e fakultetit |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | Udhëheqësi i temës së diplomës për studentët të cilët plotësojnë kushtët dhe zgjedhin të diplomohen me tëmë diploma, i nxit ata të fokusohen në analizimin dhe dokumetimin e rezultateve duke u bazuar në proven eksperimetale dhe statistikore. Studentët inkurajohen të përdorin dhe aplikojnë metoda dhe metodologji innovative të cilat do tju jepnin mundësi atyre të jenë më afër realitetit dhe nismave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe të përdorimit të teknologjive të inovacionit. Stafi akademik i |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | fakultetit është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat. (Shëmbull prezantim Diplome; Rregullore per realizimin e diplomes_mbrojtjes_vleresimit)<br>Synimi i fakultetit për zhvillimin e temave dhe punimeve cilësore është deklaruar dhe mbështetur nga stafi dhe studentët. Kjo mbështetet edhe në angazhimin e pedagogëve që udhëheqin studentët në tëmat e diplomave në faza të ndryshme. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.7**<br>**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit | Nga marrëveshjet e përmëndura në kuadër të mobiliteti dhe bashkëpunimit të stafit për kërkim shkencor, është mundësuar ngritja e kapaciteteve profesionale dhe kërkimore të personelit akademik dhe fakultetit në tërësi.<br>Disa pedagogë kanë zhvilluar vizita studimore, në institucione partnere (raporti i kërkimit) duke përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe projektet. |
| **Kriteri 2.** Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | Mbështetja e studentëve ka mundësuar krijimin e lidhjeve për të filluar shkëmbimin e eksperiencave të stafit dhe studentëve. Këto bashkëpunime kanë sjellë përmirësim të vazhdueshme të përmbajtjes së programit të studimit i cili na përmbajtjen aktuale përputhet me mjaft programe që zhvillohet në institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Zbatimi i këtyre metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve në fushën e dentistrisë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore. | Në RVB dhe takimini që GVJ realizoi me stafin akademik, Dekanin si dhe me përfaqësues të rektoratit (Sektori i kërkimit shkencor), dhe atë të projekteve dhe zhvillimit profesional u informua se, politikat e kërkimit të institucionit janë konceptuar, për të qënë gjithëpërfshirëse dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e studiuesve të rinj (strategjia e zhvillimit). Kjo formë bashkëpunimi ka favorizuar angazhimin e personelit të ri |
| **Kriteri 4.** Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | |

| | |
|---|---|
| | në aktivitete kërkimore si dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në studime, dhe në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.<br>Janë ftuar lektorë të huaj të cilët zhvillojnë takime dhe leksione të hapura në FMD (lektorët e huaj) |
